



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 4

Tiranë – E hënë, 26 janar 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 14.1.2015	Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj..... 53
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 14.1.2015	Për miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik fotovoltai, dhënë shoqërisë “Malësia Solar 1” sh.p.k..... 58
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 14.1.2015	Për miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik fotovoltai, dhënë shoqërisë “Malësia Solar 2”, sh.p.k..... 60
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 22, datë 14.1.2015	Për miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik fotovoltai, dhënë shoqërisë “Malësia Solar 3” sh.p.k..... 63
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 14.1.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 500, datë 6.7.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil”, të ndryshuar..... 65
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 14.1.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 599, datë 23.7.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike”, të ndryshuar..... 65
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 14.1.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qukës-Qafë-Plloçë, loti I (devijimi)”..... 66
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 14.1.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kv Ersekë-Përmet..... 68
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 14.1.2015	Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave për prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime..... 71

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 29, datë 14.1.2015	Për përcaktimin e procedurave, të sasive, kushteve dhe kritereve të përfshirjes së anijeve të peshkimit nga taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit.....	73
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 14.1.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”.....	74

**VENDIM****Nr. 19, datë 14.1.2015**

**PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET
PËR DHËNIEN, TRANSFERIMIN DHE
PËRSËRITJEN E LICENCËS SË
KONCESIONIT PËR RAFINERI PËR
KRYERJEN E VEPRIMTARISË SË
PËRPUNIMIT TË NAFTËS BRUTO PËR
PRODHIMIN E NËNPRODUKTEVE TË
SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pika 2, e 18, pika 3, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Çdo person juridik, i krijuar sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe i organizuar në formën e shoqërisë aksionare, mund të aplikojë për marrjen e një Licence Koncesioni për Rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj, në përputhje me rregullat që përcaktohen në këtë vendim, në bazë të parimeve të mosdiskriminimit, të trajtimit të barabartë dhe të transparencës.

2. Licenca e Koncesionit për Rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj merret nga personat juridikë të interesuar, pas pajisjes së tyre me miratimin paraprak sikurse parashikohet në kreun II dhe pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në kreun III, të këtij vendimi.

II. KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR PAJISJEN ME MIRATIM PARAPRAK

1. Personat juridikë, që kërkojnë të pajisen me Licencë Koncesioni për Rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj, përpara fillimit të ndërtimit dhe vënies në funksionim të rafinerive, paraqesin në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet një kërkesë për t’u pajisur me një miratim paraprak me qëllim vazhdimin e procedurës, të shoqëruar me këto dokumente:

1.1 Ekstraktin e regjistrimit tregtar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, ku vërtetohet se

personi juridik është i organizuar në formën e shoqërisë aksionare dhe ku të ketë të përcaktuar në objektin e veprimtarisë së tij përpunimin e naftës bruto dhe të nënprodukteve të saj dhe se statusi i personit juridik është aktiv.

1.2 Skemën dhe projektin teknologjik për secilin impiant, që do të aplikohen për ndërtimin e rafinerisë dhe ambienteve të infrastrukturës, që sigurojnë një funksionim normal të saj, përfshirë edhe projektin e mbrojtjes ndaj zjarrit, projektin e trajtimit të mbetjeve teknologjike, bilancin material dhe parashikimin e treguesve financiarë.

1.3 Skemën e furnizimit me lëndë të parë dhe atyre ndihmëse.

1.4 Studimin paraprak të fizibilitetit për veprimtarinë që do të realizojë personi juridik.

1.5 Deklaratën mjedisore në përfundim të procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, lëshuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, sipas legjislacionit në fuqi.

1.6 Genplanin e vendit ku parashikohet të ndërtohet rafineria, si dhe paraqitjen e dokumentacionit përkatës që provon marrëdhënien e aplikuesit me truallin ku parashikon të ndërtojë rafinerinë (certifikatë pronësie, kontratë blerjeje ose kontratë qiraje etj., për një periudhë jo më të vogël se vlefshmëria e licencës së koncesionit për rafineri).

1.7 Dokumentin që vërteton se përdorimi i tokës ku do të ndërtohet rafineria është parashikuar për ndërtimin e objekteve të kësaj natyre në një nga instrumentet e planifikimit të territorit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

1.8 Dokumentacionin që vërteton përvojën në fushën e ndërtimit dhe vënies në funksionim të rafinerive.

1.9 Dokumente në formën e një letre interesi, marrëveshjeje paraprake kreditimi ose çdo dokument tjetër, që vërtetojnë mbështetjen financiare të projektit nga institucionet financiare ose bankat vendase a të huaja, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione apo financime të tjera) për ndërtimin e rafinerisë.

1.10 Deklarimin për vlerën e bonusit të nënshkrimit të licencës që ofron personi juridik në rastin e pajisjes me Licencë Koncesioni për Rafineri. Vlera e bonusit të ofruar në çdo rast nuk



duhet të jetë më pak se 1 000 000 (një milion) lekë. Në këtë rast, deklarimi duhet të shoqërohet me një garanci financiare bankare për vlerën e plotë të bonusit, në bazë të së cilës garantohet pagesa e këtij bonusi menjëherë me nënshkrimin e Licencës së Koncesionit për Rafineri.

1.11 Vlerën e bonusit vjetor të trajnimit që ofron personi juridik në rastin e pajisjes me Licencë Koncesioni për Rafineri.

1.12 Dokumentin që vërteton se personi juridik nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e shoqërisë, lëshuar nga gjykata.

1.13 Dokumentin që vërteton se përfaqësuesi i personit juridik nuk ndodhet në ndjekje penale, lëshuar nga prokuroria.

1.14 Dokumentin që vërteton se personi juridik i ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga administrata tatimore.

1.15 Dokumentin që vërteton se personi juridik i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga administrata tatimore.

1.16 Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesave të energjisë elektrike për çdo ambient ku shoqëria aplikuese ushtron aktivitetin.

Dokumentet vërtetuese duhet të jenë të përpiluara në gjuhën shqipe, origjinale ose fotokopje të noterizuara. Për dokumentet e përkthyer në gjuhën shqipe vërtetimi i nënshkrimit të përkthyesit bëhet nga noteri.

2. Për vlerësimin e kërkesave dhe të dokumentacionit shoqërues, të paraqitura nga personat juridikë për t'u pajisur me miratimin paraprak për vazhdimin e procedurës për pajisjen me Licencë Koncesioni për Rafineri, pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, krijohet një komision vlerësimi, me urdhër të ministrit përgjegjës, i cili përcakton dhe mënyrën e tij të funksionimit.

2.1 Komisioni i vlerësimit duhet të ketë në përbërje përfaqësues nga:

- ministria përgjegjëse për sektorin hidrokarbur, 3 (tre) anëtarë;

- ministria përgjegjëse për zhvillimin urban dhe turizmin, 1 (një) anëtar;

- ministria përgjegjëse për ekonominë, 1 (një) anëtar;

- ministria përgjegjëse për mjedisin, 1 (një) anëtar;

- ministria përgjegjëse për pushtetin vendor, 1 (një) anëtar.

2.2 Komisioni i vlerësimit të kërkesave vlerëson kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur nga personi juridik, sipas përcaktimit të pikës 1, kreut II, të këtij vendimi.

Në rast se për të njëjtën sipërfaqe toke ka më shumë se një person juridik që plotëson kushtet për dhënien e miratimit paraprak për vazhdim procedure për pajisjen me Licencë Koncesioni për Rafineri, si kriter për përzgjedhje, komisioni të përdorë vlerën e bonuseve që ofron secili person juridik në dispozicion të buxhetit të shtetit dhe projektin teknologjik që do të aplikohet për ndërtimin e rafinerisë. Në këtë rast, në bazë të kriterëve të vlerës së bonuseve të ofruara dhe projektit teknologjik, komisioni i vlerësimit shqyrton të gjitha aplikimet dhe i propozon ministrit përgjegjës për hidrokarburet dhënien e miratimit paraprak për aplikuesin, që propozon zgjidhjen më të mirë.

3. Komisioni i vlerësimit të kërkesave mbledhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, bën verifikimin e dokumentacionit përkatës të aplikimit dhe vepron, si më poshtë vijon.

a) Kur pas verifikimit rezulton se dokumentacioni i paraqitur nga personi juridik është i rregullt, komisioni pranon kërkesën dhe, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e mbledhjes, i paraqet ministrit përgjegjës për hidrokarburet propozimin për miratimin paraprak për vazhdim të mëtejshëm të procedurës për plotësimin e dokumentacionit teknik dhe ekonomik për objektin në zonën dhe sipërfaqen e kërkuar dhe për realizimin e praktikave përkatëse deri në marrjen e Licencës së Koncesionit për Rafineri.

b) Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimet e kryera në institucionet e tjera dhe/ose në terren rezulton se nuk plotësohen kushtet e kërkuara, komisioni harton një raport dhe njofton subjektin aplikues për dokumentacionin që mungon dhe të drejtën e tij për të plotësuar dokumentacionin dhe kushtet përkatëse jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e dërgimit fillestar të njoftimit.

Subjekti aplikues ka të drejtë të riparaqesë aplikimin me dokumentacionin e plotësuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data



e njoftimit. Komisioni mbledhet dhe merr vendim brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga dita e depozitimit të dokumentacionit të plotësuar ose brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga dita e përfundimit të afatit të depozitimit nëse subjekti aplikues nuk ka bërë plotësimin e dokumentacionit.

c) Kur pas verifikimit përfundimtar rezulton se dokumentacioni i paraqitur nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 1, të kreut II, të këtij vendimi, komisioni refuzon kërkesën dhe, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e mbledhjes, i kthen personit juridik dokumentacionin përkatës, ku argumentohet vendimi i marrë. Personi juridik ka të drejtën e riaplikimit pas plotësimit e saktësimit të dokumentacionit.

ç) Kur personi juridik nuk është dakord me vendimin e komisionit, ai ka të drejtën e ankimit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e vendimit, pranë ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

4. Miratimi paraprak duhet të përmbajë të paktën këto të dhëna:

a) Emrin e personit juridik që paraqet kërkesën dhe NIPT-in;

b) Të drejtën për përgatitjen e dokumentacionit të plotë në zonën përkatëse, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për marrjen e Licencës së Koncesionit për Rafineri nga Këshilli i Ministrave;

c) Afatin kohor të vlefshmërisë së miratimit për vazhdim procedure, brenda të cilit duhet të përfundojë përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e Licencës së Koncesionit për Rafineri deri në paraqitjen e tij në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet për procedim të mëtejshëm.

Në çdo rast, ky afat nuk mund të jetë më shumë se dy vjet.

III. PROCEDURAT PËR PAJISJEN ME LICENCË KONCESIONI PËR RAFINERI

1. Personi juridik, i pajisur me miratim paraprak për vazhdim procedure, duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi, dokumentacionin për marrjen e Licencës së Koncesionit për Rafineri. Ky dokumentacion duhet të përmbajë:

1.1 ekstraktin e regjistrimit tregtar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit të personit juridik, ku të ketë të përcaktuar në objektin e veprimtarisë së tij

përpunimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj dhe se statusi i personit juridik është aktiv;

1.2 lejen e mjedisit të veprimtarisë, të lëshuar nga organi përgjegjës;

1.3 lejen e zhvillimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;

1.4 projektin e detajuar teknologjik për ndërtimin e rafinerisë dhe të ambienteve të infrastrukturës, që sigurojnë një funksionim normal të rafinerisë, përfshirë edhe projektin e mbrojtjes ndaj zjarrit, projektin e trajtimit të mbetjeve teknologjike, bilancin material dhe treguesit financiarë. Projekti teknologjik duhet të jetë i miratuar dhe nga Inspektorati Shtetëror përgjegjës;

1.5 studimin e fizibilitetit për veprimtarinë që do të realizojë personi juridik;

1.6 kartën teknologjike me parametrat e punës dhe produktet përfundimtare të përfituara në përputhje me standardet në fuqi, të miratuar nga Inspektorati Shtetëror përgjegjës;

1.7 kontratën e punësimit të drejtuesit teknik që do të ndjekë realizimin e projektit të rafinerisë dhe vënien në përdorim të saj;

1.8 genplanin e vendit ku parashikohet të ndërtohet rafineria, si dhe dokumentacionin përkatës që provon marrëdhënien e aplikuesit me truallin ku parashikon të ndërtojë rafinerinë (certifikatë pronësie, kontratë blerjeje ose kontratë qiraje etj. për një periudhë jo më të vogël se vlefshmëria e licencës së koncesionit për rafineri);

1.9 dokumentin që vërteton se personi juridik nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional, lëshuar nga gjykata;

1.10 dokumentin që vërteton se përfaqësuesi i personit juridik nuk ndodhet në ndjekje penale, lëshuar nga prokuroria;

1.11 dokumentacion në formën e një letre interesi, marrëveshjeje paraprake kreditimi ose çdo dokument tjetër, që vërtetojnë mbështetjen financiare të projektit nga institucionet financiare ose bankat vendase a të huaja, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione apo financime të tjera) për të përballuar ndërtimin e rafinerisë.

2. Licenca e Koncesionit për Rafineri përgatitet nga struktura përgjegjëse për hidrokarburet në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet në



bashkëpunim me personin juridik kërkues ose përfaqësuesin ligjor të tij.

3. Licenca e Koncesionit për Rafineri, së bashku me të gjitha dokumentet e përgatitura sipas këtij vendimi, përfshirë kopje të miratimit paraprak për vazhdim procedure, dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave.

4. Licenca e Koncesionit për Rafineri duhet të përmbajë të paktën këto të dhëna:

a) Emrin dhe selinë e personit juridik;

b) Koordinatat dhe vendndodhjen e rafinerisë;

c) Numrin dhe datën e vendimit të Këshillit të Kombëtar të Territorit për miratimin e lejes së zhvillimit;

ç) Llojin e licencës së tregtimit dhe afatin e saj, nëse personi juridik është pajisur me këtë licencë;

d) Afatin e vlefshmërisë së licencës së koncesionit, si dhe të drejtën për rinovimin e kësaj licence nëpërmjet paraqitjes së kërkesës nga personi juridik sipas procedurave të përcaktuara në kreun V, të këtij vendimi;

dh) Afatin e përfundimit të ndërtimit të rafinerisë, afatin e vënies në përdorim, si dhe rastet kur do të lejohet shtyrja e afatit të ndërtimit apo vënies në përdorim;

e) Të drejtën e organeve dhe institucioneve shtetërore, të ngarkuara me ligj, për kontrollin e zbatimit të projektit sipas kushteve dhe afatit të përcaktuar në projekt;

ë) Të drejtën e Këshillit të Ministrave për revokimin e kësaj licence kur nga kontrollet e ushtruara nga organet dhe institucionet shtetërore, të ngarkuara me ligj, konstatohet dështimi i përmbushjes së kërkesave të Licencës së Koncesionit për Rafineri, në zbatimin e parametrave teknikë, në afatin e realizimit të projektit dhe të normave mjedisore;

f) Kapacitetin dhe kategorinë e produkteve që do të prodhojë rafineria;

g) Detyrimet financiare, që personi juridik ka ndaj shtetit në lidhje me licencën e koncesionit;

gj) Detyrimin për zbatimin e kërkesave të neneve 9 dhe 12, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, për mbajtjen e rezervës së sigurisë, ndryshimet në skemën dhe kartën teknologjike të funksionimit të rafinerisë, si dhe për markën e cilësinë e nënprodukteve të naftës të prodhuara nga rafineria;

h) Të dhënat që duhet të paraqesë personi juridik në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, brenda afateve në zbatim të urdhrat të ministrit.

Në Licencën e Koncesionit për Rafineri, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, mund të përfshihen edhe përcaktime të tjera ose detyrime të ndërsjella.

5. Licenca e Koncesionit për Rafineri hartohet në tri kopje, nga të cilat një kopje mbahet në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet dhe nga një kopje u përcillet zyrtarisht personit juridik të cilit i jepet licenca e koncesionit dhe Këshillit të Ministrave.

6. Dhënia e Licencës së Koncesionit për Rafineri për ndërtimin e rafinerisë për përpunimin e naftës bruto dhe funksionimin e saj bëhet kundrejt pagesës së tarifës prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh nga personi juridik, shumë e cila derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit.

7. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të revokojë licencën e koncesionit kur gjatë kontrolleve të ushtruara nga organet dhe institucionet shtetërore, të ngarkuara me ligj, konstaton shkelje ose mosrespektim të kërkesave të Licencës së Koncesionit për Rafineri, moszbatim të parametrave teknikë të projektit dhe mosrespektim të afatit të realizimit të projektit të normave mjedisore dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në licencë që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi.

8. Personi juridik i pajisur me licencë koncesioni, në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë licencë, paraqet kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për marrjen e lejes së ndërtimit të objektit në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Në përfundim të ndërtimit të rafinerisë, personi juridik paraqet kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për marrjen e certifikatës së përdorimit të objektit në përputhje me ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

IV. PROCEDURAT PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË KONCESIONIT PËR RAFINERI

1. Transferimi i licencës së rafinerive të naftës nga personi juridik i pajisur me Licencë Koncesioni për Rafineri tek një person tjetër juridik bëhet vetëm nëse personi juridik ka plotësuar detyrimet



ligjore dhe financiare ndaj organeve shtetërore dhe pas miratimit nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Transferimi i Licencës së Koncesionit për Rafineri bëhet pasi personi juridik, tek i cili transferohet, përmbush kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin, në bazë të të cilit është dhënë fillimisht licenca e koncesionit, përveç rasteve kur këto kërkesa u referohen kushteve që nuk janë më të nevojshme të përmbushen. Në çdo rast, në dokumentacionin e paraqitur nga personi juridik, tek i cili transferohet licenca, duhet të garantohet se do të zbatohen parametrat teknikë të projektit, do të respektohet afati i realizimit të projektit, normat mjedisore dhe detyrimet e tjera të parashikuara në Licencën e Koncesionit për Rafineri.

3. Mbajtësi i Licencës së Koncesionit për Rafineri dhe personi juridik, tek i cili do të transferohet, paraqesin në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet një kërkesë të përbashkët për transferim, të shoqëruar me dokumentacionin e subjektit tek i cili kërkohet që të transferohet licenca e koncesionit, që provon përmbushjen e kërkesave të parashikuara në pikat 1.1, 1.2, 1.4, 1.6, 1.7, 1.9 e 1.10, të pikës 1, të kreut III, të këtij vendimi, si dhe çdo dokumentacion tjetër që provon mbështetjen financiare për subjektin tek i cili realizohet transferimi.

Dokumentet vërtetuese duhet të jenë të përpiluara në gjuhën shqipe, origjinale ose fotokopje të noterizuara. Për dokumentet e përkthyer në gjuhën shqipe vërtetimi i nënshkrimit të përkthyesit bëhet nga noteri.

Struktura përgjegjëse për hidrokarburet në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet bën verifikimin e dokumentacionit e të plotësimit të kushteve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të këtij kreu.

4. Kur dokumentet janë të plota dhe të rregullta, ministri përgjegjës për hidrokarburet miraton transferimin e licencës përkatëse të koncesionit sipas kushteve dhe procedurave të këtij vendimi.

5. Afati për verifikimin e dokumentacionit, si dhe përfundimin e praktikës procedurale dhe administrative për transferimin e licencës përkatëse të koncesionit nuk mund të jetë më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e mbërritjes së kërkesës së përbashkët të dy personave juridikë.

6. Kur nga vërtetimi i të dhënave dhe i treguesve rezulton se nuk plotësohen kushtet e kërkuara, dokumentet e paraqitura u kthehen subjekteve, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e mbërritjes së kërkesës. Personat juridikë mund t'i riparaqesin dokumentet pas plotësimit të tyre brenda një periudhe jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e njoftimit për plotësimin e dokumentacionit.

Në rast se personat juridikë nuk paraqesin dokumentacionin e kërkuar brenda periudhës së përcaktuar prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, ministria përgjegjëse për hidrokarburet refuzon këtë kërkesë.

Personat juridikë kanë të drejtë të paraqesin ankesë në gjykatën kompetente, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e refuzimit të kërkesës.

7. Licenca e Koncesionit për Rafineri, pas miratimit të transferimit, përmban të dhënat që përcaktohen në pikën 4, të kreut III, të këtij vendimi, duke ndryshuar informacionin që lidhet me subjektin juridik përfitues të lejes së koncesionit.

Licenca e Koncesionit për Rafineri, pas miratimit të transferimit, është një dokument me të njëjtin numër, por me fraksion, i dokumentit të mëparshëm të licencës së koncesionit që ka marrë personi juridik. Licenca e Koncesionit për Rafineri hartohet në tri kopje, nga të cilat një kopje mbahet në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet dhe nga një kopje u përcillet zyrtarisht personit juridik së cilit i jepet licenca e koncesionit dhe Këshillit të Ministrave.

V. PROCEDURAT PËR PËRSËRITJEN E LICENCËS SË KONCESIONIT PËR RAFINERI

1. Personi juridik i pajisur me Licencën e Koncesionit për Rafineri ka të drejtë për rinovimin e saj, nëpërmjet paraqitjes së kërkesës nga personi juridik, jo më vonë se 1 vit para përfundimit të afatit të licencës.

2. Mbajtësi i Licencës së Koncesionit për Rafineri paraqet në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet kërkesën për përsëritje të licencës, të shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në pikat 1.1, 1.2, 1.4, 1.6, 1.7, 1.9 e 1.10, të pikës 1, të kreut III, të këtij vendimi.

Gjithashtu, subjekti duhet të paraqesë vërtetimin se janë respektuar kushtet dhe normat teknike, në kuptimin e funksionimit të sigurt të rafinerisë, sigurisë në punë dhe të garantimit të



cilësisë së nënprodukteve, lëshuar nga organi përgjegjës.

Dokumentet vërtetuese duhet të jenë të përpiluara në gjuhën shqipe, origjinale ose fotokopje të noterizuara. Për dokumentet e përkthyer në gjuhën shqipe vërtetimi i nënshkrimit të përkthyesit bëhet nga noteri.

3. Kërkesa për përsëritjen e Licencës së Koncesionit për Rafineri së bashku me të gjitha dokumentet shqyrtohet nga struktura përgjegjëse për hidrokraburet në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet.

4. Përsëritja e Licencës së Koncesionit për Rafineri bëhet kundrejt pagesës prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh nga personi juridik, shumë e cila derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit.

VI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Vendimi nr. 553, datë 12.8.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve të koncesionit për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerive, naftësjiellësve e gaz-sjiellësve”, të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Dispozitat e vendimit nr. 553, datë 12.8.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve të koncesionit për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerive, naftësjiellësve e gazsjiellësve”, të ndryshuar, zbatohen për procedurat e dhënies së licencave të koncesionit të rafinerive, aplikimet e të cilave janë depozituar në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM Nr. 20, datë 14.1.2015

PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TË NDËRTIMIT TË CENTRALIT ELEKTRIK FOTOVOLTAIK, DHËNË SHOQËRISË “MALËSIA SOLAR 1” SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 34/1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

Faqe | 58

VENDOSI:

1. Miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik fotovoltai, dhënë shoqërisë “Malësia Solar 1”, sh.p.k., sipas tekstit dhe koordinatave të zonave të përcaktuara në hartën përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
EDI RAMA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË DHE INDUSTRIË AUTORIZIM

NR. _____ DATË ____.

PËR NDËRTIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK FOTOVOLTAIK NGA SHOQËRIA “MALËSIA SOLAR 1” SHPK

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 34/1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar,

Duke pasur parasysh se:

a) Shoqëria “Malësia Solar 1” sh.p.k. është pajisur me autorizimin paraprak nr. 3370/10, datë 21.6.2014 prej MEI-t, për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltai në fshatin Lohaj e Poshtme (Malësia e Madhe), qarku Shkodër;

b) “Malësia Solar 1” sh.p.k. ka paraqitur studimin e plotë të fizibilitetit teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor e social, bazuar në të dhëna të zonës së zbatimit të projektit;

c) “Malësia Solar 1” sh.p.k. ka paraqitur planin e biznesit të projektit;

ç) “Malësia Solar 1” sh.p.k. ka paraqitur grafikun e zbatimit të projektit;

d) OST sh.a. ka miratuar pikën e lidhjes me shkresën nr. 1942/1 datë 29.4.2013;

dh) “Malësia Solar 1” sh.p.k. ka marrë lejet dhe autorizimet mjedisore nga institucionet përgjegjëse;



e) “Malësia Solar 1” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin që provon të drejtat e pronësisë mbi tokën që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë autorizon shoqërinë “Malësia Solar 1” sh.p.k., e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, me nr. NUIS L22419008E, me seli në adresën: Komuna e Parisit, rruga “Hysen Zalosnjë”, pallati 1/1, Tiranë, për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaiik në përputhje me kushtet dhe karakteristikat e mëposhtme:

- Fuqi të instaluar, 2.5 MWp;
- Prodhimtari të pritshme totale të energjisë elektrike, prej 4500-5000 MWh/vit;
- Numri total i moduleve fotovoltaiik është 9800 copë;
- Fuqia mesatare e një moduli, 255 Wp;
- Modulet do të jenë të konfiguruar në grupe “string” me 18 module secila.
- Këndet optimale janë përkatësisht: 27.40 gradë për sezonin veror (1 prill – 30 shtator) dhe 55.52 gradë për sezonin dimëror (1 tetor – 31 mars).
- Pika e lidhjes me rrjetin e transmetimit do të jetë në zbarrat 20 kV të N/St. 220/110/20, Koplík (OST sh.a.).

1. Shoqëria “Malësia Solar 1” sh.p.k. do të përfundojë ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaiik brenda muajit mars 2017.

2. “Malësia Solar 1” sh.p.k. të paraqesë në MEI projektin e plotë të zbatimit teknik brenda një periudhe prej 1 (një) muaji nga data e hyrjes në fuqi e këtij autorizimi.

3. “Malësia Solar 1” sh.p.k. është e detyruar të raportojë çdo 3 muaj pranë MEI-t mbi ecurinë e ndërtimit të centralit elektrik me erë, duke filluar nga data e fillimit të ndërtimit. MEI-t ka të drejtë t'i kërkojë “Malësia Solar 1” sh.p.k., çdo informacion që e konsideron të nevojshëm lidhur me zbatimin e kushteve të këtij autorizimi.

4. Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij autorizimi, midis “Malësia Solar 1” sh.p.k. dhe MEI-t do të nënshkruhet një kontratë lidhur me afatet e realizimit dhe penaltetet në rast mosrealizimi në kohë apo transferimi të autorizimit.

5. “Malësia Solar 1” sh.p.k., në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për

ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, do t'i paguajë çdo vit ministrisë përgjegjëse për energjinë një *royalty*, të barabartë me 2% të sasisë së energjisë vjetore të prodhuar nga centrali fotovoltaiik ose vlerën në lekë të kësaj sasive energjie, së bashku me çdo përfitim aksesor të shoqërisë në lidhje me sasinë e *royalty* prej 2% efektivisht të përfituar në bazë të incentivave të tregut të energjisë së rinovueshme.

6. Shoqërisë i rezervohet një zone buferike me një rreze prej 50 metrash nga kufiri i centralit sipas koordinatave të zonës ku pozicionohen komponentët.

7. Autorizimi mund të revokohet nga ministria përgjegjëse për energjinë në rastet e mëposhtme:

a) me kërkesë me shkrim të “Malësia Solar 1” sh.p.k., për raste të veçanta të justifikuara;

b) “Malësia Solar 1” sh.p.k. nuk respekton detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në këtë autorizim dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë, nuk paraqet arsyet justifikuese të dokumentuara për mosrealizimin dhe nuk merr masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet përkatëse;

c) “Malësia Solar 1” sh.p.k. nuk informon MEI mbi arsyet që mund të shpien në vonesa ndaj realizimit të ndërtimit të paktën 60 (gjashtëdhjetë ditë) përpara periudhës së përfundimit të afatit të ndërtimit;

ç) Vërtetohet se deklaratimet e “Malësia Solar 1” sh.p.k. nuk janë të vërteta;

d) Kur për “Malësia Solar 1” sh.p.k. kanë filluar procedurat e falimentimit ose likuidimit, sipas ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”.

dh) “Malësia Solar 1” sh.p.k., për arsye të shkaktuara nga ajo vetë, nuk ka respektuar programin e punimeve, dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë, nuk paraqet arsyet për mosrealizimin e detyrës dhe nuk paraqet masat që do të ndërmarrë për të përfunduar centralin elektrik me erë në datën e përcaktuar;

e) “Malësia Solar 1” sh.p.k. nuk respekton detyrimin për informimin dhe nëse brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas njoftimit paraprak nga MEI për mosdhënie informacioni, përsëri nuk dërgon informacionin e kërkuar;


ë) Në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë

17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar.

8. Kohëzgjatja e këtij autorizimi është 25 vjet duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij autorizimi.

Ky autorizim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIJË
Damian Gjijnuri



VENDIM

Nr. 21, datë 14.1.2015

PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TË NDËRTIMIT TË CENTRALIT ELEKTRIK FOTOVOLTAIK, DHËNË SHOQËRISË “MALËSIA SOLAR 2”, SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 34/1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik fotovoltai, dhënë shoqërisë “Malësia Solar 2”, sh.p.k., sipas tekstit dhe koordinatave të zonave të përcaktuara në hartën përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INDUSTRIË

AUTORIZIM

NR. _____ DATË _____.2015

**PËR NDËRTIMIN E CENTRALIT
ELEKTRIK FOTOVOLTAIK NGA
SHOQËRIA “MALËSIA SOLAR 2” SHPK**

Në mbështetje të pikës 1 dhe 2 të nenit 34/1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar,

Duke pasur parasysh se:

a) Shoqëria “Malësia Solar 2” sh.p.k. është pajisur me autorizimin paraprak nr. 3371/4, datë 21.6.2014 prej MEI, për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaiik në Lohaj e Poshtme (Malësia e Madhe), qarku Shkodër;

b) “Malësia Solar 2” sh.p.k. ka paraqitur studimin e plotë të fizibilitetit teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor e social, bazuar në të dhëna të zonës së zbatimit të projektit;

c) “Malësia Solar 2” sh.p.k. ka paraqitur planin e biznesit të projektit;

ç) “Malësia Solar 2” sh.p.k. ka paraqitur grafikun e zbatimit të projektit;

d) OST Sh.a. ka miratuar pikën e lidhjes me shkresën nr. 1942/1, datë 29.4.2013;

dh) “Malësia Solar 2” sh.p.k. ka marrë lejet dhe autorizimet mjedisore nga institucionet përgjegjëse;

e) “Malësia Solar 2” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin që provon të drejtat e pronësisë mbi tokën që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë autorizon shoqërinë “Malësia Solar 2” sh.p.k., e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, me nr. NUIS L22419007T, me seli në adresën: Komuna e Parisit, rruga “Hysen Zalosnjaja”, pallati 1/1, Tiranë, për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaiik në përputhje me kushtet dhe karakteristikat e mëposhtme:

- Fuqi të instaluar 2.5 MWp;

- Prodhimtari të pritshme totale të energjisë elektrike, prej 4500-5000 MWh/vit;

- Numri total i moduleve fotovoltaiik është 9800 copë;

- Fuqia mesatare e një moduli, 255 Wp;

- Modulet do të jenë të konfiguruar në grupe “string” me 18 module secila;

- Këndet optimale janë përkatësisht: 27.40 gradë për sezonin veror (1 prill – 30 shtator) dhe 55.52 gradë për sezonin dimëror (1 tetor – 31 mars);

- Pika e lidhjes me rrjetin e transmetimit do të jetë në zbarrat 20 kV të n/st. 220/110/20 Koplik (OST sh.a).

1. Shoqëria “Malësia Solar 2” sh.p.k. do të përfundojë ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaiik brenda muajit mars 2017.

2. “Malësia Solar 2” sh.p.k. të paraqesë në MEI projektin e plotë të zbatimit teknik brenda një periudhe prej 1 (një) muaji nga data e hyrjes në fuqi e këtij autorizimi.

3. “Malësia Solar 2” sh.p.k. është e detyruar të raportojë çdo 3 muaj pranë MEI mbi ecurinë e ndërtimit të centralit elektrik me erë, duke filluar nga data e fillimit të ndërtimit. MEI ka të drejtë t’i kërkojë “Malësia Solar 2” sh.p.k. çdo informacion që e konsideron të nevojshëm lidhur me zbatimin e kushteve të këtij autorizimi.

4. Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij autorizimi, midis “Malësia Solar 2” sh.p.k. dhe MEI do të nënshkruhet një kontratë lidhur me afatet e realizimit dhe penalitetet në rast mosrealizimi në kohë apo transferimi të autorizimit.

5. “Malësia Solar 2” sh.p.k., në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, do t’i paguajë çdo vit ministrisë përgjegjëse për energjinë një *royalty* të barabartë me 2% të sasisë së energjisë vjetore të prodhuar nga centrali fotovoltaiik ose vlerën në lekë të kësaj sasive energjie, së bashku me çdo përfitim aksesor të shoqërisë në lidhje me sasinë e *royalty* prej 2% efektivisht të përfutur në bazë të incentivave të tregut të energjisë së rinovueshme.

6. Shoqërisë i rezervohet një zonë buferike me një rreze prej 50 metrash nga kufiri i centralit sipas

koordinatave të zonës ku pozicionohen komponentët.

7. Autorizimi mund të revokohet nga ministria përgjegjëse për energjinë në rastet e mëposhtme:

a) me kërkesë me shkrim të “Malësia Solar 2” sh.p.k. për raste të veçanta të justifikuara;

b) “Malësia Solar 2” sh.p.k. nuk respekton detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në këtë autorizim dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë, nuk paraqet arsyet justifikuese të dokumentuara për mosrealizimin dhe nuk merr masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet përkatëse;

c) “Malësia Solar 2” sh.p.k. nuk informon MEI-n mbi arsyet që mund të shpien në vonesa ndaj realizimit të ndërtimit të paktën 60 (gjashtëdhjetë ditë) përpara periudhës së përfundimit të afatit të ndërtimit;

ç) Vërtetohet se deklaratimet e “Malësia Solar 2” sh.p.k. nuk janë të vërteta;

d) Kur për “Malësia Solar 2” sh.p.k. kanë filluar procedurat e falimentimit ose likuidimit, sipas ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”.

dh) “Malësia Solar 2” sh.p.k., për arsye të shkaktuara nga ajo vetë, nuk ka respektuar

programin e punimeve, dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë, nuk paraqet arsyet për mosrealizimin e detyrës dhe nuk paraqet masat që do të ndërmarrë për të përfunduar centralin elektrik me erë në datën e përcaktuar;


e) “Malësia Solar 2” sh.p.k. nuk respekton detyrimin për informimin dhe nëse brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas njoftimit paraprak nga MEI për mosdhënie informacioni, përsëri nuk dërgon informacionin e kërkuar;

ë) Në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar.

8. Kohëzgjatja e këtij autorizimi është 25 vjet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij autorizimi.

Ky autorizim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
Damian Gjiknuri



**VENDIM****Nr. 22, datë 14.1.2015****PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TË
NDËRTIMIT TË CENTRALIT
ELEKTRIK FOTOVOLTAIK, DHËNË
SHOQËRISË “MALËSIA SOLAR 3” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 34/1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik fotovoltaik, dhënë shoqërisë “Malësia Solar 3”, sh.p.k., sipas tekstit dhe koordinatave të zonave të përcaktuara në hartën përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****REPUBLIKA E SHQIPËRISË****MINISTRIA E EKONOMISË DHE INDUSTRIËS****AUTORIZIM****NR. _____ DATË _____.2015****PËR NDËRTIMIN E CENTRALIT
ELEKTRIK FOTOVOLTAIK
NGA SHOQËRIA “MALËSIA SOLAR 3”
SHPK**

Në mbështetje të pikës 1 dhe 2 të nenit 34/1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar,

Duke pasur parasysh se:

a) Shoqëria “Malësia Solar 3” sh.p.k. është pajisur me autorizimin paraprak nr. 3372/4, datë

21.6.2014 prej MEI-t, për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik në Lohaj e Poshtme (Malësia e Madhe), qarku Shkodër;

b) “Malësia Solar 3” sh.p.k. ka paraqitur studimin e plotë të fizibilitetit teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor e social, bazuar në të dhëna të zonës së zbatimit të projektit;

c) “Malësia Solar 3” sh.p.k. ka paraqitur planin e biznesit të projektit;

ç) “Malësia Solar 3” sh.p.k. ka paraqitur grafikun e zbatimit të projektit;

d) OST sh.a. ka miratuar pikën e lidhjes me shkresën nr. 1942/1, datë 29.4.2013;

dh) “Malësia Solar 3” sh.p.k. ka marrë lejet dhe autorizimet mjedisore nga institucionet përgjegjëse;

e) “Malësia Solar 3” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin që provon të drejtat e pronësisë mbi tokën që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë autorizon Shoqërinë “Malësia Solar 3” sh.p.k. e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, me nr. NUIS L22419006L, me seli në adresën: Komuna e Parisit, rruga “Hysen Zalosnjn”, pallati 1/1, Tiranë, për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik në përputhje me kushtet dhe karakteristikat e mëposhtme:

- Fuqi të instaluar, 2.5 MWp;
- Prodhimtari të pritshme totale të energjisë elektrike, prej 4500-5000 MWh/vit;
- Numri total i moduleve fotovoltaik është 9800 copë;
- Fuqia mesatare e një moduli, 255 Wp;
- Modulet do të jenë të konfiguruar në grupe “string” me 18 module secila;
- Këndet optimale janë përkatësisht: 27.40 gradë për sezonin veror (1 prill – 30 shtator) dhe 55.52 gradë për sezonin dimëror (1 tetor – 31 mars);
- Pika e lidhjes me rrjetin e transmetimit do të jetë në zbarrat 20 kV të n/st. 220/110/20 Koplik (OST sh.a.).

1. Shoqëria “Malësia Solar 3” sh.p.k. të përfundojë ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik brenda muajit mars 2017.

2. “Malësia Solar 3” sh.p.k. të paraqesë në MEI projektin e plotë të zbatimit teknik brenda një periudhe prej 1 (një) muaji nga data e hyrjes në fuqi e këtij autorizimi.

3. “Malësia Solar 3” sh.p.k. është e detyruar të raportojë çdo 3 muaj pranë MEI-it mbi ecurinë e



ndërtimit të centralit elektrik me erë, duke filluar nga data e fillimit të ndërtimit. MEI ka të drejtë t'i kërkojë “Malësia Solar 3” sh.p.k. çdo informacion që e konsideron të nevojshëm lidhur me zbatimin e kushteve të këtij autorizimi.

4. Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij autorizimi, midis “Malësia Solar 3” sh.p.k. dhe MEI do të nënshkruhet një kontratë lidhur me afatet e realizimit dhe penaltetet në rast mosrealizimi në kohë apo transferimi të autorizimit.

5. “Malësia Solar 3” sh.p.k., në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, do t'i paguajë çdo vit ministrisë përgjegjëse për energjinë një *royalty* të barabartë me 2% të sasisë së energjisë vjetore të prodhuar nga centrali fotovoltaiik ose vlerën në lekë të kësaj sasive energjie së bashku me çdo përfitim aksesor të shoqërisë në lidhje me sasinë e *royalty* prej 2% efektivisht të përfituar në bazë të incentivave të tregut të energjisë se rinovueshme.

6. Shoqërisë i rezervohet një zonë buferike me një rreze prej 50 metrash nga kufiri i centralit sipas koordinatave të zonës ku pozicionohen komponentët.

7. Autorizimi mund të revokohet nga ministria përgjegjëse për energjinë në rastet e mëposhtme:

a) me kërkesë me shkrim të “Malësia Solar 3” sh.p.k., për raste të veçanta të justifikuara;

b) “Malësia Solar 3” sh.p.k. nuk respekton detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në këtë autorizim dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë, nuk paraqet arsyet justifikuese të dokumentuara për mosrealizimin dhe nuk merr masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet përkatëse;

c) “Malësia Solar 3” sh.p.k. nuk informon MEI-n mbi arsyet që mund të shpien në vonesa ndaj realizimit të ndërtimit të paktën 60 (gjashtëdhjetë ditë) përpara periudhës së përfundimit të afatit të ndërtimit;

ç) Vërtetohet se deklaratimet e “Malësia Solar 3” sh.p.k. nuk janë të vërteta;

d) Kur për “Malësia Solar 3” sh.p.k. kanë filluar procedurat e falimentimit ose të likuidimit, sipas ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”.

dh) “Malësia Solar 3” sh.p.k. për arsye të shkaktuara nga ajo vetë nuk ka respektuar programin e punimeve, dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë, nuk paraqet arsyet për mosrealizimin e detyrës dhe nuk paraqet masat që do të ndërmarrë për të përfunduar centralin elektrik me erë në datën e përcaktuar;


e) “Malësia Solar 3” sh.p.k. nuk respekton detyrimin për informimin dhe nëse brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas njoftimit paraprak nga MEI për mosdhënie informacioni, përsëri nuk dërgon informacionin e kërkuar;

ë) Në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar.

8. Kohëzgjatja e këtij autorizimi është 25 vjet duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij autorizimi,

9. Ky autorizim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
Damian Gjijnuri

**VENDIM**

Nr. 23, datë 14.1.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 500, DATË 6.7.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR EMËRIMIN E KRYETARIT DHE ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010, "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 500, datë 6.7.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në numrin rendor 3, fjalët "Z. Ervin Minarolli, anëtar", zëvendësohen me "Z. Engjëll Agaçi, anëtar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 25, datë 14.1.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 599, DATË 23.7.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PAGESAVE QË KRYHEN NË AKEP, PËR CAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E FREKUENCAVE, TË NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 3, e 119, pika 2, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, të vendimit nr. 599, datë 23.7.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, tabela nr. 1, në pikën 2.1, dhe tabela nr. 3, në pikën 2.3, zëvendësohen, përkatësisht, me tabelën nr. 1 dhe tabelën nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI

TABELA NR. 1

Në lekë

Nr.	Brezat e frekuencave [MHz]	Njësia e matjes së brezit	Pagesa vjetore në lekë
1	(450-470)	(2*5) MHz	1.500.000
2	(790-880)	(2*5) MHz	1.400.000
3	(880-915) / (925-960)	(2*200) kHz	42.000
4	(1710-1785) / (1805-1880)	(2*200) kHz	42.000
5	(1920-1980) / (2110-2170)	(2*5) MHz	840.000
6	(1900-1920); (2010-2025)	(1*5) MHz	420.000
7	(2500-2570) / (2620-2690)	(2*5) MHz	720.000
8	(2570-2620)	(1*5) MHz	360.000
9	(3400-3600) / (3600-3800)	(2*5) MHz	600.000

TABELA NR. 3

Në lekë

Brezi i frekuencave	Gjerësi kanali (BW)			
	BW≤3.5MHz	3.5<BW≤20MHz	20<BW≤40MHz	BW>40MHz
$f \leq 1$ GHz	18.000			
1GHz < $f \leq 14$ GHz	24.000	30.000	33.000	45.000
14 GHz < $f \leq 20$ GHz	21.000	27.000	30.000	39.000
20 GHz < $f \leq 37$ GHz	16.800	21.000	27.000	30.000
37 GHz < $f \leq 39.5$ GHz	12.000	18.000	21.000	27.000
$f > 39.5$ GHz	4.800	6.000	7.200	9.000

VENDIM

Nr. 26, datë 14.1.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “QUKËS-QAFË-PLLOÇË, LOTI I (DEVIJIMI)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

Faqe | 66

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qukës-Qafë-Plloçë, loti I (Devijimi)”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë tokë “arë” dhe “drufrutorë”, me një vlerë të përgjithshme shpronësimit prej 6 313 446 (gjashtë milionë e treqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) lekësh, nga të cilat:



a) për tokë “arë”, me sipërfaqe shpronësimi 26 894 (njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) m², me vlerën 4 994 206 (katër milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtë) lekë;

b) për “drufrutorë”, me vlerën 1 319 240 (një milion e treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet) lekë.

4. Vlera totale e shpronësimit prej 6 313 446 (gjashtë milionë e treqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2015, zëri “Detyrimet e prapambetura”.

5. Shpenzimet procedurale, në shumën 487 000 (katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e

Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, në favor të shtetit.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA EMËRORE E PRONAREVE QE SHPRONËSOHEN në SEGMENTIN RRUGOR
QUKËS-QAFË-PLLOÇE” LOTI I (DEVJIMI)

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Numri i pasurisë	Sip. Totale (m2)	Sip.	Çmimi (lekë/m ²)	Shuma (lekë)	Kult. Bujq Drufutore (lekë)	SHUMA TOTALE (lekë)	
FSHATI QUKËS-SHKUMBIN Z.K. 3120												
1	Agim	Sali	Leka	3120	443/43	867	540	149	80460	94480	174940	Konf. ZVRPP
2	Agim	Sali	Leka	3120	443/45	550	200	149	29800	15400	45200	Konf. ZVRPP
FSHATI KARKAVEC Z.K. 2096												
3	Demir	Merko	Blloshim	2096	363/4	8312	1780	217	386260	205800	592060	Konf. ZVRPP
4	Demir	Merko	Blloshim	2096	363/7	1360	390	217	84630		84630	Konf. ZVRPP
FSHATI BËRZESHTË Z.K. 1169												
5	Haki		Dashballa	1169	175	2977	346	184	63664	46640	110304	Konf. ZVRPP
6	Hamit		Dashballa	1169	177	2509	1256	184	231104	25640	256744	Konf. ZVRPP
7	Islam		Blloshmi	1169	178	4667	1595	184	293480	119800	413280	Konf. ZVRPP
8	Dilaver		Blloshmi	1169	223/1	4368	1310	184	241040	25650	266690	Konf. ZVRPP
9	Dilaver		Blloshmi	1169	223/2	500	375	184	69000	2240	71240	Konf. ZVRPP
10	Sherif		Blloshmi	1169	224	4700	1890	184	347760	46560	394320	Konf. ZVRPP
11	Xheladin		Zharri	1169	226/2	8044	5195	184	955880	100500	1056380	Konf. ZVRPP



12	Behare		Leka	1169	1059/2	15937	1540	184	283360	193600	476960	Konf. ZVRPP
	Dashamir		Leka									
	Ilirjan		Leka									
13	Shefqet		Leka	1169	1059/4	14112	747	184	137448	93900	231348	Konf. ZVRPP
14	Petref		Leka	1169	1060/2	4500	1110	184	204240	111100	315340	Konf. ZVRPP
15	Fejzie		Leka	1169	1060/3	4500	2500	184	460000	47500	507500	Konf. ZVRPP
16	Fejzie		Leka	1169	1061/2	10000	310	184	57040	96000	153040	Konf. ZVRPP
17	Demir		Leka	1169	1062/1	3500	673	184	123832	10650	134482	Konf. ZVRPP
18	Zenel		Leka	1169	1062/2	10000	637	184	117208	9750	126958	Konf. ZVRPP
19	Agime		Frakulli	1169	1062/3	2400	435	184	80040	87750	87790	Konf. ZVRPP
20	Adil		Xhanani	1169	1062/4	2400	505	184	92920	9600	102520	Konf. ZVRPP
21	Pellumb		Leka	1169	1063/1	3875	1245	184	229080		229080	Konf. ZVRPP
22	Pellumb		Leka	1169	1063/2	1875	1385	184	254840	40480	295320	Konf. ZVRPP
23	Pellumb		Leka	1169	1066	3500	430	184	79120		79120	Konf. ZVRPP
24	Qamil		Alla	1169	265	9281	500	184	92000	16200	108200	Konf. ZVRPP
		SHUMA					26894		4994206	1319240	6313446	



LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 110 kV
ERSEKË – PËRMET

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë arë, truall, pyll, kullotë

Nr.	Numri i shtyllës	Pronësia										
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia Sip. e pronës m²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime
Qarku Korçë												
ERSEKË		1594										
1	1	Sotir		Prifti	are	1594	25/40	4400	25.54	135	3448.29	
2	2	Shefqet		Dodo	are	1594	259/44	3556	47.83	135	6457.19	
3	3	Pretendim pronësie			are	1594	259/67	44447	15.16	135	2045.99	
4	4	Pretendim pronësie			are	1594	259/67/1	7276	15.16	135	2045.99	
								Σ =	103.68	Σ =	13997.46	

Qarku Korçë												
KOMUNA QENDËR												
Nr.	Numri i shtyllës	Pronësia										
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia Sip. e pronës m²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime
TAC QENDER		3558										
1	6	Fatmir	Avdulla	Mydini	arë	3558	315/21	4025	15.16	135	2045.99	
2	7	Petrit	Hysni	Lifo	arë	3558	318/5	1317	23.17	135	3128.57	
3	9	Ferit	Hasan	Mydini	arë	3558	540/13	5450	15.16	135	2045.99	
								Σ =	53.49	Σ =	7220.54	

TAC I POSHTEM		3556					Z =	33.49	Z =	1220.34	
1	10	Pretendim Pronësie		are	3556	574/9	90859	16.59	142	2355.68	
							Σ =	16.59	Σ =	2355.68	

BOROVE		1251										
1	13	Kita	Kostandin	Mediu	arë	1251	337/1	2526	16.59	135	2239.56	
2	14	Robert	Themistokli	Qoku	arë	1251	340/1	2704	15.16	135	2045.99	
3	15	Kristo	Ziko	Gega	arë	1251	355/2	11882	23.17	135	3128.57	
4	17	Nikola	Ziko	Gorica	arë	1251	369/2	5000	15.16	135	2045.99	
								Σ =	70.07	Σ =	9460.10	

Qarku Korçë												
KOMUNA BARMASH												
Nr.	Numri i shtyllës	Pronësia										
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia Sip. e pronës m ²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime
BARMASH		1119										
1	30	Spiro	Illi	Karai	arë	1119	46	3315	50.87	135	6867.41	
2	31	Xhelo	Nexhip	Duro	arë	1119	186	2475	15.16	135	2045.99	
3	32	Spiro	Aristotel	Dhembu	arë	1119	554	2443	21.28	135	2872.77	
4	33	Arben	Jorgji	Risto	arë	1119	728	2724	23.17	135	3128.57	
5	34	Viktor	Mitre	Lilo	arë	1119	869	5076	15.16	135	2045.99	
6	35	Sotir	Illi	Lilo	arë	1119	948	11013	15.16	135	2045.99	
								Σ =	140.79	Σ =	19006.71	

SHALES		3117										
1	46	Sotir	Ligor	Misha	arë	3117	60	22204	16.59	135	2239.56	
2	47	Petro	Sotir	Ile	arë	3117	149	10960	16.59	135	2239.56	
3	48	Pretendim Pronësie			arë	3117	195	8097	15.16	135	2045.99	
4	49	Koco	Ligor	Bello	arë	3117	259	8840	16.59	135	2239.56	
								Σ =	64.92	Σ =	8764.66	

Qarku Korçë												
KOMUNA LESKOVIK												
Nr.	Numri i shtyllës	Pronësia										
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia Sip. e pronës m²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime
RADANJE		3134										
1	59	Nexhip	Vehap	Lilo	arë	3134	112	855	47.83	135	6457.19	
								Σ =	47.83	Σ =	6457.19	

VREPCKE		3826									
1	63	Pretendim pronësie		ledh	3826	54	8426	19.65	105	2063.41	
2	64	Pretendim pronësie		are	3826	42	45756	18.09	142	2568.50	
							Σ =	37.74	Σ =	4631.90	

LESKOVIK		2430									
1	83	Pretendim pronësie		Kullote	2430	379/3		19.65	87	1709.68	
2	92	Pretendim pronësie			2430	920/2		47.83	135	6457.19	
3	93	Pretendim pronësie			2430	902/5		16.59	135	2239.56	
							Σ =	84.07	Σ =	10406.43	



Nr.	Numri i shtyllës	Pronësia										
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia Sip pronës m²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime
Qarku Gjirokastrë												
KOMUNA ÇARÇOVE												
ÇARÇOVE						1356						
1	113	Bashkëpronësi			Are	1356	108		19.65	135	2652.95	
2	119	Trifon	Peci	Cicolli	Are	1356	22/1	2272	23.17	135	3128.57	
3	120	Bashkëpronësi			Are	1356	19/27	1330	15.16	135	2045.99	
								Σ =	57.98	Σ =	7827.51	

ZHEPE		3927										
1	121	Petrit	Hasan	Ahmeti	Are	3927	711	3415	15.16	135	2045.99	
2	122	Pretendim pronësie			Are	3927	689	10042	15.16	135	2045.99	
3	123	Pretendim pronësie			Are	3927	178	22837	15.16	135	2045.99	
4	124	Pretendim pronësie			Are	3927	179	25689	15.16	135	2045.99	
5	125	Sotir	Koco	Nika	Are	3927	158	4048	15.16	135	2045.99	
6	126	Mitre	Kici	Proko	Are	3927	89	1121	15.16	135	2045.99	
7	127	Dhimiter	Thanas	Deraso	Are	3927	44	4246	25.54	135	3448.29	
								Σ =	116.48	Σ =	15724.21	

DRAÇOVE		1523										
1	130	Josif	Ilia	Shukollari	Are	1523	466	3580	47.83	135	6457.19	
2	131	Sofokli	Aleks	Keruti	Are	1523	310	3860	85.24	135	11506.77	
3	132	Sotir	Themistokli	Shukollari	Are	1523	254	1327	23.17	135	3128.57	
4	133	Sotir	Vasil	Nasi	Are	1523	110	5575	18.09	135	2441.88	
5	134	Spiro	Kici	Tetollari	Are	1523	71	943	18.09	135	2441.88	
								Σ =	192.42	Σ =	25976.30	

Qarku Gjirokastrë													22716.56	
KOMUNA ÇARÇOVE														
Nr.	Numri i shtyllës	Pronësia												Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia Sip pronës m²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m²	Vlera e kompensimit në lekë			
KANIKOL		2073												
1	135	Gogo	Ndreko	Petro	Are	2073	139	4976	16.59	135	2239.56			
2	136	Janaq	Spiro	Stefani	Are	2073	88	3687	47.83	135	6457.19			
								Σ =	64.42	Σ =	8696.75			

ILJARE		1981										
1	137	Bashkëpronësi			are		771	1376	15.16	135	2045.99	
2	137				Are	1981	770	652		135		
								Σ =	15.16	Σ =	2045.99	

PELLUMBAR		2899										
1	138	Bashkëpronësi			Are	2899	280	11800	15.16	135	2045.99	
2	139	Stavro	Vangjel	Papa	Are	2899	196	8171	47.83	135	6457.19	
3	140	Lonidha	Dhimiter	Peci	Are	2899	140	5773	57.04	135	7700.03	
								Σ =	120.02	Σ =	16203.20	

STREMBEC		3524										
1	143	Thanas	Stefan	Qirollari	Are	3524	1030	2715	39.59	135	5345.06	
2	144	Pano	Miti	Qirollari	Are	3524	1016	2691	15.16	135	2045.99	
3	145	Ferdinand	Janaq	Ristani	Are	3524	908	2762	15.16	135	2045.99	
4	146	Sotir	Llazo	Qirollari	Are	3524	621	1666	15.16	135	2045.99	
5	147	Isuf	Teki	Nuredini	Are	3524	459	2271	23.17	135	3128.57	
6	149	Jorgji	Mihal	Pecollari	Are	3524	193	2238	18.09	135	2441.88	
								Σ =	126.32	Σ =	17053.47	

Qarku Gjirokastrë												
KOMUNA PETRAN												
Nr.	Numri i shtyllës	Pronësia										
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia Sip. e pronës m²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime
KALUDH		2057										
1	151	Pretendim pronësie			arë	2057	510	4038	56.49	135	7626.18	
2	152	Jano	Josif	Thanasi	arë	2057	452	400	47.83	135	6457.19	
3	153	Ligor	Pandeli	Sotiri	arë	2057	424	484	18.09	135	2441.88	
4	154	Bashkëpronësi			arë	2057	297		21.28	135	2872.77	
5	155	Kolo	Koco	Proko	arë	2057	221	8310	19.65	135	2652.95	
6	156	Thanas	Koco	Sotiri	arë	2057	140	1272	18.09	135	2441.88	
								Σ =	181.43	Σ =	24492.86	

PETRAN		2946										
1	160	Vladimir	Argjir	Simoni	arë	2946	159/11	4508	47.83	179	8561.76	
	160	Sheme	Ismail	Lulo	arë	2946	159/12					
2	161	Stavro	Nastas	Proko	arë	2946	159/7	8753	15.16	179	2712.83	
3	162	Josif	Kolo	Mitre	arë	2946	159/3	5901	15.16	179	2712.83	
4	163	Pretendent pronësie			arë	2946	154/2	2500	25.54	179	4572.18	
5	164	Pretendent pronësie			kullotë	2946	149	5400	75.97	114	8660.43	



6	165	Pretendent pronësie			arë	2946	140		86.79	179	15535.03	
7	166	Bashkëpronësi			arë	2946	144		47.83	179	8561.76	
8	167	Bashkëpronësi			arë	2946	73	29500	15.16	179	2712.83	
9	168	Bashkëpronësi			arë	2946	142/1	5800	15.16	179	2712.83	
10	169	Asan	Refat	Goxhaj	arë	2946	124/2	606	18.09	179	3237.75	
11	170	Xhelo	Muharrem	Halimi	arë	2946	116/4	522	47.83	179	8561.76	
									$\Sigma =$	410.50	$\Sigma =$	68541.97

Qarku Gjirokastrë
KOMUNA PETRAN

Nr.	Numri i shtyllës	Pronësia											Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia Sip. e pronës m²	Sipërfaqja e shpronësimit	Çmimi i tokës lekë/m²	Vlera e kompensimit në lekë		
BADELONJE		1071											
1	172	Pretendent pronësie			arë	1071	87/5	8062	15.16	135	2045.99		
	172	Pretendent pronësie			arë	1071	91	1843		135			
2	173	Koco	Petro	Poci	arë	1071	84/2	2332	16.59	135	2239.56		
3	174	Dylber	Xhemal	Tare	arë	1071	17/5	6413	23.17	135	3128.57		
4	175	Shezai	Abedin	Ferati	arë	1071	15/34	3058	85.24	135	11506.77		
5	176	Pretendent pronësie			arë	1071	209/16	5250	34.48	135	4655.33		
6	177	Bashkëpronësi			arë	1071	208		18.09	135	2441.88		
								Σ =	192.73	Σ =	26018.10		

QILARISHT		3115										
1	182	Kici	Mina	Tatazi	arë	3115	377/112	3080	65.87	179	11790.63	
2	183	Petraç	Kici	Tatazi	arë	3115	256/13	2900	16.59	179	2969.49	
3	184	Margarita	Sotir	Nasi	arë	3115	257/14	2845	15.16	179	2712.83	
4	185	Pretendent Pronësie			arë	3115	285/4		47.83	179	8561.76	
									$\Sigma =$	145.45	$\Sigma =$	26034.71

		3967										
1	186	Pretendent pronësie			arë	3967	160/10		15.16	179	2712.83	
2	187	Pretendent pronësie			arë	3967	137/19		18.09	179	3237.75	
3	188	Pretendent pronësie			arë	3967	133/9		39.59	179	7087.15	
4	191	Pretendent pronësie			arë	3967	150/8		47.83	179	8561.76	
5	192	Pretendent pronësie			arë				76.98	179	13779.97	
									$\Sigma =$	197.65	$\Sigma =$	35379.46

Tabela përmbledhëse

Nr.	Objekti	Sip. shpronësimi	SHUMA TOTALE NË LEKË
1	Linja 110kV Ersekë - Përmet	2439.74	356295.20

VENDIM

Nr. 28, datë 14.1.2015

**PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË
PUNËVE TË BRENDSHME PËR
KRYERJEN E PROCEDURAVE PËR
PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE
PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË,
MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE
TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA E
SHËRBIME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe të pikës 2, të nenit 2, të tekstit “Rregullat e prokurimit publik”, bashkëlidhur vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për hartimin e rregullave të prokurimit publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve të poshtëshënuara:

- Blerje automjete;
- Blerje karburanti, përveç vajurit Jet A1 dhe karburanti për nevojat e bordeve të kullimit;
- Blerje materialesh kancelarie;
- Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrtar;
- Blerje materialesh të ndryshme për pastrim;
- Blerje uniformash, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera, përbërëse të tyre;
- Blerje këpucësh;
- Blerje pjesësh ndërrimi për automjete, për shërbimet profilaktike, përveç filtrave të automjeteve;



- f) Blerje tonerash;
- g) Blerje pajisjesh elektronike dhe telekomunikacioni;
- gj) Shërbim gatimi dhe shpërndarjeje ushqimi;
- h) Sigurimi automjetesh;
- i) Shërbim pastrimi;
- j) Shërbim lyerje ndërtesash.

1.1 Përfshijmish, lejohet Ministria e Mbrojtjes t'i realizojë vetë procedurat e prokurimit për:

- a) Blerje uniformash, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;
- b) Blerje këpucësh.

1.2 Përfshijmish për vitin 2015, lejohet Ministria e Integritetit Evropian t'i realizojë vetë procedurat e prokurimit për:

- a) Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash;
- b) Blerje pajisjesh elektronike dhe telekomunikacioni;
- c) Shërbim lyerjeje ndërtesash.

2. Ministria e Punëve të Brendshme të prokurorë fondin limit, të llogaritur si shumë e fondeve buxhetore, të miratuar për çdo institucion, për secilin nga mallrat dhe shërbimet e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, brenda datës 31 janar, të dërgojnë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si organi qendror blerës, të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës për çdo prokurim.

4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të mallrave e të shërbimeve, sipas artikujve të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi;
- b) Të bashkërendojë punën me autoritetet kontraktore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për prokurimet publike, që do të zhvillojë si organ qendror blerës;
- c) Të verifikojë përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore me ligjin dhe standardet në fuqi;

ç) të shqyrtojë dhe të miratojë specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore.

Nëse gjykohet se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me ligjin për prokurimet publike ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, organi qendror blerës kryen rishikimin e specifikimeve teknike, në

bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste, organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra.

d) Të unifikojë specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste, organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra.

dh) Të bashkërendojë punën për testimin e tregut për përlogaritjet e të dhënave sasiore për mallrat, që do të prokurohen, para publikimit të tenderit. Në këto raste, organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra.

e) Të shqyrtojë ankesat e operatorëve ekonomikë deri në shpalljen e njoftimit të fituesit.

5. Organi qendror blerës, në raste përfshijmish, mund të zhvillojë procedurë prokurimi edhe kur kërkohet nga një autoritet a një grup autoritetesh kontraktore, që nuk janë përcaktuar në këtë vendim apo edhe për mallra a shërbime, që nuk janë përcaktuar në këtë vendim.

6. Organi qendror blerës, në rast se autoritetet kontraktore kanë kërkesa, pasi është bërë publikimi i njoftimit të kontratës së prokurimit, verifikon arsyet e vonës dhe vendos për shpalljen ose jo të procedurës së re të prokurimit për këto kërkesa.

7. Ngarkohet Agjencia e Prokurimit Publik të udhëzojë autoritetet kontraktuese për zbatimin e këtij vendimi.

8. Vendimi nr. 53, datë 21.1.2009, i Këshillit të Ministrave, "Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime", i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 29, datë 14.1.2015****PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE,
TË SASIVE, KUSHTEVE DHE
KRITEREVE TË PËRJASHTIMIT TË
ANIJEVE TË PESHKIMIT NGA TAKSA E
QARKULLIMIT DHE TAKSA E
KARBONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 9, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anijet e peshkimit përjashtohen nga pagesa e taksës së qarkullimit dhe taksës së karbonit në momentin e blerjes së karburantit. Shoqëri furnizuese të karburantit (gazoilit) për anijet e peshkimit janë vetëm shoqëritë aksionare, të licencuara në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të cilat disponojnë magazinë doganore ose

magazinë fiskale.

2. Furnizohen me gazoil dhe benzinë, pa paguar taksën e qarkullimit dhe taksën e karbonit, të gjitha anijet e peshkimit, persona juridikë dhe fizikë, të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 20, të vendimit nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat””, të ndryshuar, dhe që janë të pajisura me statusin e përdoruesit të përjashtuar dhe të pritësit të regjistruar nga autoritetet doganore, për përfitimin e përjashtimit nga pagesa e akcizës së produkteve energjetike.

3. Normativat teknike dhe teknologjike të konsumit të karburantit për anijet e peshkimit jepen në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Procedurat dhe kriteret e furnizimit të anijeve të peshkimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për peshkimin.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1**NORMATIVAT TEKNIKE DHE TEKNOLOGJIKE TË KONSUMIT TË KARBURANTIT PËR ANIJET E PESHKIMIT****I. Peshkimi fundor – Pelagjik (koeficienti lit/kg = 0.84)****A – anije peshkimi 150 hp**

- Konsumi orar max. = $165 \text{ g/hp/orë} \times 150 = 24.7 \text{ kg/orë} = 29.3 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $29.3 \times 0.7 = 20.5 \text{ lit/orë}$

B – Anije peshkimi 300 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ g/hp/orë} \times 300 = 49 \text{ kg/orë} = 58.2 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $58.2 \times 0.7 = 40.8 \text{ lit/orë}$

C- Anije peshkimi 400 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ g/hp/orë} \times 400 = 66 \text{ kg/orë} = 78.4 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $78.4 \times 0.7 = 54.9 \text{ lit/orë}$

D- Anije peshkimi 600 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ g/hp/orë} \times 600 = 99 \text{ kg/orë} = 117.6 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $117.6 \times 0.7 = 82.3 \text{ lit/orë}$

E- Anije peshkimi 1000 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ g/hp/orë} \times 1000 = 165 \text{ kg/orë} = 196 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $196 \times 0.7 = 137.2 \text{ lit/orë}$

II. Peshkimi me rrethim**A- Anije peshkimi 80 deri 600 hp**

- Konsumi orar max. = $165 \text{ g/hp/orë} \times 300 = 49 \text{ kg/orë} = 58.2 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $58.2 \times 0.50 = 29.1 \text{ lit/orë}$

III. Peshkimi selektiv**A- Anije peshkimi 80 hp**

- Konsumi orar max. = $165 \text{ g/hp/orë} \times 80 = 14.4 \text{ kg/orë} = 17 \text{ lit/orë}$



- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $17 \times 0.7 = 12$ lit/orë

B- M/Flluga peshkimi 40 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ g/hp/orë} \times 40 = 6.6 \text{ kg/orë} = 8 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $8 \times 0.7 = 5.6 \text{ lit/orë}$

C- M/Lança peshkimi 20 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ g/hp/orë} \times 20 = 3.4 \text{ kg/orë} = 4 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $4 \times 0.7 = 2.8 \text{ lit/orë}$

D- M/Lança peshkimi 10 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ g/hp/orë} \times 10 = 1.7 \text{ kg/orë} = 2 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $2 \times 0.7 = 1.4 \text{ lit/orë}$

Në përlogaritjet e konsumit faktik të karburantit për anije dhe forma të ndryshme peshkimi janë marrë në konsideratë:

1. Gjysmë ore ndezje e motorit në bankinë para nisjes për të arritur parametrat teknikë të punës, si dhe praktikë nisje.

2. Në Durrës e Vlorë, dy orë ecje e lirë deri në zonën e peshkimit dhe dy orë kthim në port.

3. Në Shëngjin dhe Sarandë, një orë ecje e lirë deri në zonën e peshkimit dhe një orë kthim në port.

4. 20% e kohës në peshkim, llogaritet në lëshim veglash peshkimi dhe virim.

5. 10% ecje e lirë, motori në minimum, grise e karikim trate, kolaudim pajisje peshkimi etj.

6. Rreth 60% e kohës pune efektive, tralim.

7. Janë marrë në konsideratë edhe rastet e kthimit në port pa peshkim, për kohë të keqe, defekte teknike, etj.

8. Të gjitha përlogaritjet kanë si qëllim të përcaktojnë vetëm konsumin orar të karburantit, e për rrjedhojë sasia e karburantit që harxhohet del nga koha e punës faktike në det të anijes, shumëzuar me konsumin e aprovuar në orë të paraqitur më sipër.

Në përfundim përcaktimi i normativës së harxhimit të karburantit për anijet e peshkimit, është bërë në vija të përgjithshme mbi bazën e formulës:

$$K = \frac{0.70 \times \text{HP (max)} \times S \times T}{D}$$

K → Konsumi i karburantit të motorit për një kohë të caktuar

0.70 → Koeficient mesatar i përdorimit të motorit

HP (max) → Fuqia maksimale e motorit në HP (kuaj fuqi)

S → Konsumi specifik i motorit sipas llojeve në g/hp/orë

D → Densiteti i karburantit = 0.84

T → Koha në punë e motorit, (e cila mund të zëvendësohet me distancën e përshkruar në milje, pjesëtuar me shpejtësinë në nyje të anijes).

VENDIM

Nr. 30, datë 14.1.2015

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 612, DATË 5.9.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT “PËR AKCIZAT”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 108 e 109, të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, “Përkufizime”, shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:

“8. “Prodhim”, përdorimi i makinave, mjeteve dhe punës në njësi të tilla si: rafineri, kombinat, uzina, fabrika, punishte, për të shndërruar materialin (lëndë e parë, përbërës etj.) në produkte akcize.”.

Neni 2

Paragrafi i tretë, i pikës 1, të nenit 3, “Regjistrimi i pritësit të regjistruar/licencimi i përfaqësuesit fiskal”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Kërkuesi aplikon për regjistrim pranë zyrës doganore mbikëqyrëse. Zyra doganore mbikëqyrëse, pas vlerësimit të plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë vendim për marrjen e statusit të pritësit të regjistruar, dërgon

dokumentacionin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Në rast se kërkesat e parashikuara konsiderohen të plotësuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëshon autorizimin përkatës sipas aneksit 21, të këtij vendimi.”

Neni 3

Shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 4, “Kushtet për regjistrim si pritës i regjistruar dhe për licencim si përfaqësues fiskal”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Pritësi i regjistruar duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

i) Të jetë i regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe të paraqesë ekstraktin historik nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR);

ii) Të depozitojë një garanci të nevojshme për të mbuluar veprimet e lëvizjes së produkteve të akcizës me pezullim të detyrimeve, vetëm në rast se kërkuesi do të kërkojë të garantojë lëvizjen;

iii) Të paraqesë dëshmi penaliteti të përfaqësuesit të shoqërisë/administratorit;

iv) Të paraqesë dëshmi që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj administratës doganore;

v) Të japë një përshkrim të produkteve të akcizës që do të trajtojë;

vi) Të paraqesë të dhëna për kapacitetin maksimal mbajtës të ambientit/ve të stokimit.”

Neni 4

Në pikën 4, të nenit 17, “Rastet e përjashtimeve”, përcaktimi “3-fishi” zëvendësohet me “5-fishi”.

Neni 5

Pas pikës 14, të nenit 20, shtohet pika 15, me këtë përmbajtje:

“15. Detyrimet e pikës 3, të këtij neni, lindin edhe në rastin kur një subjekt peshkimi furnizohet me gazoil jashtë Republikës së Shqipërisë, si furnizim bordi. Sasitë e blera jashtë Republikës së Shqipërisë regjistrohen nga autoriteti doganor.”

Neni 6

Neni 21 shfuqizohet.

Neni 7

Në pikën 1, të nenit 23, “Mangësitë/diferencat”, hiqen fjalët “... Për qëllime të pikës 1, të nenit 11, të ligjit, ...”.

Neni 8

Në pikën 6, të nenit 25, “Humbjet aksidentale dhe avaritë në magazinën fiskale”, fjalët “... Qendra operative e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ...” zëvendësohen me “... Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit dhe Drejtoria e Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ...”.

Neni 9

Në nenin 37, “Kërkesa për rimbursim ose shuarje”, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, shfuqizohen.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Rimbursimi i akcizës nuk mund të kërkohet nëse produkti i akcizës nuk është përdorur/konsumuar deri në 1 vit nga data e pagesës së akcizës. Paraqitja e kërkesës për rimbursim, në çdo rast, duhet të respektojë kushtëzimet e përcaktuara në nenet specifike të rimbursimit për këtë qëllim.”

Neni 10

Pikat 2 dhe 3, të nenit 39, “Rimbursimi në eksport”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Zyra doganore territorialisht kompetente miraton ose refuzon fillimin e procedurës së eksportit me rimbursim të akcizës.

3. Nëse procedura miratohet, kërkuesi depoziton pranë zyrës doganore territorialisht kompetente dokumentin DAV për eksport.”

Neni 11

Në nenin 43, “Rimbursimi për serrat me ngrohje dhe prodhimet industriale dhe agroindustriale”, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në fund të pikës 4 shtohen fjalët “... të muajit paraardhës ...”.

2. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Mbas verifikimit dhe konfirmimit të rregullsisë së dokumentacionit të kërkuar, zyra doganore mbikëqyrëse, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kryen llogaritjet për rimbursimin e akcizës, bazuar në aneksin 10 “Tabela referuese e normativave të harxhimit të lëndës djegëse”.”.

Neni 12

Pika 1, e nenit 44, “Rimbursimi për biokarburantet”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Do të konsiderohen biokarburante dhe lëndë të tjera djegëse të rinovueshme për transport, bazuar në proceset e ndryshimeve teknologjike, produktet e mëposhtme, me kushtin që të prodhohen në Republikën e Shqipërisë nga njësitë për prodhimin e biokarburanteve, sipas përcaktimit të nenit 5, të ligjit nr. 9876, datë 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, të ndryshuar:

a) Produktet që klasifikohen në kodin 27 10 20 të NK, në rastet kur produkti BIO i përzier me karburant përbën më pak se 30% të volumit;

b) Produktet që klasifikohen në kodin 38 26 00 të NK kur produkti BIO i përzier me karburant përbën më shumë se 30% të volumit.”.

Neni 13

Neni 46, “Procedura e rimbursimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 46

Procedura e rimbursimit

1. Dalja e produktit biokarburant nga regjimi pezullues i magazinës fiskale bëhet me dokumentin DSHA-ja me detyrime të paguara.

2. Depozituesi i miratuar, me përfundimin e procesit të prodhimit, magazinon në një depozitë të veçantë, pjesë e magazinës fiskale, gjithë sasinë e biokarburantit të prodhuar nga njësia e prodhimit, sipas përcaktimeve të shkronjës “dh”, të pikës 1, të nenit 14, të ligjit, dhe njofton zyrën doganore mbikëqyrëse, sipas modelit 1 “Njoftim për prodhim biokarburanti”, të aneksit 24, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Zyra doganore mbikëqyrëse, brenda 1 (një) dite pune nga data e marrjes së njoftimit, paraqitet të depozituesi i miratuar dhe verifikon sasinë e produktit, merr mostrat e nevojshme dhe plumbos depozitën ku është magazinuar biokarburanti i prodhuar. Në përfundim të këtij procesi, nga punonjësit e autorizuar të zyrës doganore mbikëqyrëse mbahet një procesverbal sipas modelit 2 “Procesverbal verifikimi”, të aneksit 24, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe

është pjesë përbërëse e tij, dhe, brenda 2 (dy) ditësh pune dërgohen mostrat për analizim në Laboratorin Doganor.

4. Laboratori Doganor, brenda 3 (tri) ditësh pune nga data e marrjes së mostrave, i njofton rezultatin e analizave laboratorike zyrës doganore mbikëqyrëse.

5. Depozita ku është magazinuar biokarburanti qëndron e plumbosur dhe nën mbikëqyrjen doganore. Çdo dalje biokarburanti nga kjo depozitë bëhet nën mbikëqyrjen e zyrës doganore duke plotësuar dokumentin DSHA-ja sipas përcaktimit të pikës 1 dhe duke përshkruar llojin e produktit në përputhje me të dhënat e certifikatës së analizave dhe numrin e certifikatës. Për çdo dalje nga magazina plotësohet njëkohësisht modeli 3 “Kartelë inventari produkti” e aneksit 24, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Në rast se autoritetet doganore konstatojnë dëmtim të plumbëve doganore apo mosrakordim të sasive, bllokojnë depozitën, vendosin plumbçet e reja dhe nuk lejojnë dalje të mëtejshme të produktit. Autoritetet doganore kryejnë të gjitha verifikimet dhe veprimet e mëtejshme për të përcaktuar shkaqet dhe evidentuar përgjegjësitë në përputhje me ligjin. Për sasinë e produktit gjendje në depozitë rikryhen procedurat e përcaktuara në pikat 3 dhe 4.

7. Një herë në muaj depozituesi i miratuar paraqet kërkesë për rimbursim të akcizës për sasinë e produktit BIO të trupëzuar në sasinë e karburanteve të deklaruara për konsum, shoqëruar përkatësisht me dokumentin DSHA-ja me detyrime të paguara dhe me modelin 3 “Kartelë inventari produkti”, të aneksit 24 dhe certifikatën e Laboratorit Doganor.

Autoritetet doganore, pasi shqyrtojnë kërkesën duke krahasuar të dhënat e deklaruara me rezultatet e Laboratorit Doganor, brenda 10 ditësh pune, autorizojnë ose refuzojnë rimbursimin duke dhënë arsyt në rast refuzimi.

Në rast se gjatë kontrollit rezultojnë se ka pasur pasaktësi ose pavërtetësi të dokumenteve, subjekti përfitues i rimbursimit duhet të kthejë të gjithë shumën e rimbursuar dhe ndaj tij zbatohen masat dhe penalitetet e përcaktuara nga ligji.”.



Neni 14

Në nenin 50, “Personat që ushtrojnë aktivitetin e depozituesit të miratuar”, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “ç”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) operatorët që rafinojnë apo përpunojnë produkte energjetike në rafineri apo stabilimente të tjera prodhimi.”

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Për qëllime të pikës 1, të këtij neni, konsiderohen depozitues të miratuar joproduhues personat që blejnë, presin, dërgojnë, mbajnë dhe shesin produkte që i nënshtrohen akcizës. Këta depozitues i mbajnë produktet e akcizës me synim për t'i dërguar, eksportuar, riekportuar apo shitur.”

Neni 15

Pas nenit 50 shtohet neni 50/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 50/1

Statusi i operatorëve që administrojnë veprimtarinë e pullave fiskale

Për qëllime të neneve 40-43, të seksionit 8, të kreut V, të ligjit, operatorët ekonomikë, për të cilët Këshilli i Ministrave ka ofruar me koncesion pjesë apo të gjithë veprimtarinë që lidhet me pullat fiskale, duhet të marrin statusin e depozituesit të miratuar prodhues/përpunues.”

Neni 16

Në nenin 51, “Procedurat e aplikimit dhe të autorizimit të magazinave fiskale”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Kërkesës t'p duhet t'i bashkëlidhen dokumentet e mëposhtme:

a) Ekstrakti historik nga QKR-ja;

b) Prokura e përfaqësuesit ligjor për marrjen përsipër të përgjegjësi të shoqërisë, për rastet kur nuk përcaktohet në ekstraktin e QKR-së;

c) Dëshmi penaliteti e përfaqësuesit të shoqërisë/administratorit;

ç) Planimetria e ambienteve të planifikuara për magazinë fiskale, të shoqëruara me foto për çdo plan si brenda ashtu edhe jashtë;

d) Plani dhe përshkrimi i instalimeve të ndryshme që do të jenë pjesë e magazinës fiskale (instalime, depo, rezervuarë, tubacione etj.);

dh) Akti i kalibrimin të kontejnerëve (depozitave, sillosa etj.) nga DPM-ja, në rastet kur do të depozitohen lëngje apo materiale rifuxho. Për rastet kur marrja e certifikatës së kalibrimin është në proces, të depozitohet kërkesa e aplikimit shoqëruar me certifikatat e kalibrimin të disponueshme në momentin e prodhimit/importit;

e) Certifikimet përkatëse për instrumentet dhe pajisjet matëse nga DPM-ja;

ë) Deklarata për natyrën dhe pozicionin tarifor të produkteve që priten, dërgohen, mbahen dhe në rastin e magazinave të prodhimit edhe të lëndëve të para dhe produkteve të prodhuara;

f) Karta teknologjike me parametrat e punës, lëndët e para dhe produktet përfundimtare të përfutuara sipas standardeve të përcaktuara më parë;

g) Vlerësimi i sasive të produkteve të akcizës të prodhuara, të përpunuara dhe të depozituara/të stokuara për një periudhë të caktuar (vjetore apo që mbulon aktivitetin nëse është sezonale);

gj) Dokumenti i garancisë;

h) Informacioni për sistemin kontabël që përdor shoqëria, si dhe masat e kontrollit të brendshëm e metodat e kontrollit që ajo përdor;

i) Konfirmimi se shoqëria nuk ka asnjë detyrim të pashlyer ndaj administratës doganore në momentin e aplikimit.”

2. Pikat 8, 9 dhe 11 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“8. Në rast se plotësohen të gjitha kërkesat e parashikuara, lëshohet autorizimi përkatës, pasi të jenë gjeneruar në sistemin informatik kodet fiskale specifike, sipas modelit në aneksin 12. Autorizimet lëshohen pa afat kohor.

9. Në autorizimin e magazinës fiskale, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përcaktohen elementet specifike të magazinës fiskale, në varësi të natyrës dhe proceseve që do të kryhen në të si dhe përcaktohet edhe zyra doganore mbikëqyrëse.”

“11. Çdo ndryshim apo modifikim, që lidhet me depozitat, rezervuarët, instalimet, kushtet e shfrytëzimit të magazinës fiskale dhe çdo ndryshim në dokumentacionin e dorëzuar për marrjen e autorizimit, duhet të jetë objekt i një informacioni paraprak për zyrën doganore mbikëqyrëse, e cila, pas kontrollit, verifikimit dhe vlerësimit, përcjell këto ndryshime pranë



Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave vlerëson dhe pasqyron ndryshimet apo modifikimet në autorizimin fillestar.”.

Neni 17

Në nenin 60 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 2, referenca “... të shkronjës “h”, të pikës 6, ...” zëvendësohet me “... të shkronjës “ë”, të pikës 6, ...”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:

“3. Me konstatimin e njërit prej rasteve të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “ë”, të pikës 6, të nenit 20, të ligjit, dhe në përputhje me shkronjën “d”, të pikës 6, të nenit 20, të ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave merr vendim për pezullimin e autorizimit, për një afat deri në 30 ditë. Ky vendim paraqet arsyet e këtij pezullimi dhe u njoftohet operatorit ekonomik dhe zyrës doganore mbikëqyrëse, e cila merr të gjitha masat e duhura për të siguruar që gjatë këtij afati kohor operatori ekonomik të mos kryejë asnjë aktivitet tregtar në magazinën fiskale.

4. Kur operatori ekonomik nuk ka mundur të rregullojë situatën brenda 30 ditëve, por siguron që kushtet mund të përmbushen nëse afati i pezullimit zgjatet, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të shtyjë afatin e pezullimit edhe për 30 ditë të tjera.

5. Nëse brenda afatit të pezullimit operatori ekonomik plotëson kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen sipas ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave anulon pezullimin dhe informon operatorin ekonomik dhe zyrën doganore mbikëqyrëse lidhur me këtë vendim.”.

3. Pika 3 bëhet pika 6 dhe ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Nëse brenda këtij afati kohor, të përcaktuar në pikat 3 dhe 4, operatori ekonomik nuk plotëson mangësitë që kanë çuar në pezullimin e autorizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave merr vendim për revokimin e autorizimit:

a) duke njoftuar zyrën doganore mbikëqyrëse dhe depozituesin e miratuar në lidhje me vendimin e revokimit;

b) duke përcaktuar detyrat e zyrës doganore mbikëqyrëse për procedurat e mëtejshme;

c) duke përcaktuar detyrimet e depozituesit të miratuar për procedurat e mëtejshme;

ç) duke përcaktuar të drejtën e depozituesit të miratuar për t’u ankimuar dhe organin pranë të cilit ushtrohet ky ankimim”.

Neni 18

Shkronja “a”, e nenit 65, “Përdorimi i dokumentit shoqërues të akcizës (DSHA)”, shfuqizohet.

Neni 19

Pika 10, e nenit 68, “Procedurat e inventarizimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Procesverbali i inventarizimit rimerr vetëm faktet e konstatuara gjatë kontrollit. Ky procesverbal është i ndryshëm nga procesverbali i verifikimit të shkeljeve, i cili miratohet me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, por përbën bazën për hartimin e këtij të fundit.”.

Neni 20

Shkronja “ç”, e pikës 1, të nenit 69, “Tepricat dhe mangësitë në inventarizim”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) Në fund të inventarizimit, për tepricat kryhet regjistrimi në rubrikën ‘Hyrje të kontabilitetit të stokut’, me përshkrimin ‘Tepricë e evidentuar nga kontrolli’, si dhe shënohen ekstremitetet e procesverbalit të përcaktuar në shkronjën “c”, të kësaj pike. Të gjitha këto veprime duhen kryer përpara kryerjes së veprimeve të tjera hyrëse.”.

Neni 21

Në nenin 75 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pas shkronjës “c”, të pikës 1, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) shuma e garancisë që duhet paraqitur nga operatorët që administrojnë veprimtarinë e pullave fiskale, të referuar në nenin 50/1, është në vlerë fikse prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh.”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Shuma e garancisë vlerësohet dhe llogaritet nga zyra doganore mbikëqyrëse nga llogaria e detyrimeve për produktet e akcizës sipas shtojcës 1 të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.”.

Neni 22

Në nenin 123 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:



1. Në pikën 1, fjalët "... procedurën e përgjithshme ..." zëvendësohen me "... me denatyrues të njohur në shtete të tjera, të ndryshme nga denatyruesit e përcaktuar në nenet 124 dhe 125 ...".

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4, këtë përmbajtje:

"3. Operatorët ekonomikë, të cilët, pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 1, nuk deklarojnë se do të kryejnë operacione rikuperimi apo rigjenerimi, duhet të depozitojnë pranë zyrës doganore të importit një garanci e cila duhet të mbulojë shumën e plotë të detyrimit të akcizës që paguhet në rast se ky mall do të rikuperohet apo do të rigjenerohet dhe duhet të mbulojë një afat jo më të vogël se një vit.

4. Zyra doganore e importit procedon me verifikimin e zinxhirit tregtar deri në destinacionin e fundit të produktit të hedhur për konsum. Pas verifikimit nëpërmjet kontrollit pas zhdoganimit se alkooli i denatyruar nuk është rikuperuar apo rigjeneruar, zyra doganore në fjalë çliron garancinë."

Neni 23

Në nenin 124 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 1, pas fjalëve "... që i nënshtrohet denatyrimit ..." shtohen "... brenda vendit ...".

2. Në pikën 4, përcaktimi "(98.9°C)" zëvendësohet me "(78.9°C)".

Neni 24

Në nenin 133 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, shkronjat "d" e "p" zëvendësohen me shkronjat "ç" e "dh".

2. Në pikën 2, shkronja "d" zëvendësohet me shkronjën "ç".

Neni 25

Në nenin 135 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "d" zëvendësohet me shkronjën "ç".

2. Në fund të fjalisë, togfjalëshi "... depozituesit të miratuar ..." zëvendësohet me "... pritësit të regjistruar ...".

Neni 26

Në nenin 136 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja "e" zëvendësohet me shkronjën "d".

2. Në pikën 2, shkronja "h" zëvendësohet me shkronjën "ë".

Neni 27

Në pikat 1 dhe 2, të nenit 137, shkronja "p" bëhet "dh".

Neni 28

Në nenin 138, shkronja "g" bëhet "e".

Neni 29

Në pikën 1, të nenit 139, shkronjat "g", "i" dhe "j" zëvendësohen, përkatësisht, me shkronjat "e", "p" dhe "g".

Neni 30

Shkronja "a", e nenit 147, shfuqizohet.

Neni 31

Në nenin 149 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe zëvendësohet me "Pritësit e regjistruar".

2. Pika 3 shfuqizohet.

3. Pika 4 bëhet pika 3 dhe referenca "... në pikat 2 dhe 3 ..." zëvendësohet me "... në pikën 2 ...".

Neni 32

Në pikën 2, të nenit 155, "Procedurat e përjashtimit", fjalët "... brenda 3 (tri) ditëve ..." zëvendësohen me "... brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve ...".

Neni 33

Në pikën 2, të nenit 156, "Procedurat e rimbursimit", fjalët "... brenda 3 (tri) ditëve ..." zëvendësohen me "... brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve ...".

Neni 34

Në nenin 157, "Dispozitat tranzitore", bëhen këto ndryshime:

1. Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"10. a) Për subjektet e akcizës, që u janë pranuar e proceduar nga administrata tatimore kërkesat për shkatërrimin e produkteve të akcizës para datës 1 tetor 2012, sipas ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002, "Për akcizat", të ndryshuar, dhe të gjitha akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, administrata tatimore vijon këto procedura deri në përfundimin e tyre dhe informon Ministrinë e Financave për vlerën totale të detyrimit të akcizës së paguar, e cila



do t'u rimburohet subjekteve nga administrata tatimore si detyrim i prapambetur në bazë të vendimit nr. 50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”. Ky proces të përfundojë brenda datës 30 qershor 2015.

b) Për subjektet e akcizës, që kanë bërë kërkesa për nisje të procedurës për shkatërrimin e produkteve të akcizës para datës 1 tetor 2012 dhe kjo procedurë nuk ka nisur si pasojë e mosngritjes së komisionit të përcaktuar në pikën 50.2, shkronja “d”, të udhëzimit nr.7, datë 16.6.2003, të ministrit të Financave, “Për akcizat”, të ndryshuar, apo ka mbetur e papërfunduar për shkaqe të tjera që nuk varen nga subjekti i akcizës, procedura do të fillojë/do të vijojë të ndiqet nga administrata tatimore sipas ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002, “Për akcizat”, të ndryshuar, dhe të gjitha akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Për trajtimin e kërkesave për shkatërrim sipas kësaj pike, të cilat janë administruar deri në datën 1 tetor 2012, do të ngrihet nga drejtori i përgjithshëm i Tatimeve një komision “*ad-hoc*” dhe me përbërje sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore të përmendura më sipër.

Në përfundim të kësaj procedure, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon Ministrinë e Financave për vlerën totale të detyrimit të akcizës së paguar, e cila do t'u rimburohet subjekteve nga administrata tatimore si detyrim i prapambetur në bazë të vendimit nr. 50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”. Ky proces të përfundojë brenda datës 30 qershor 2015.

c) Brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të procedurave sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve paraqet

raportin përkatës të ministri i Financave.”.

2. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Për subjektet e akcizës, që kanë dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, para datës 1 tetor 2012 ose do të sjellin edhe mbas kësaj datë pulla akcize të dëmtuara deri në datën 1 tetor 2012, administrata tatimore do të zbatojë procedurat e pikës 50, të udhëzimit nr. 7, datë 16.6.2003, “Për akcizat”, të ndryshuar, dhe në përfundim të tyre i dërgon administratës doganore në rrugë zyrtare informacion për sasinë e pullave të akcizës, ndërsa akciza do t'u rimburohet subjekteve nga administrata tatimore si detyrim i prapambetur në bazë të vendimit nr. 50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”. Këto procedura të përfundojnë brenda datës 30 qershor 2015.”.

Neni 35

Aneksi 4 zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 36

Në aneksin 16, pjesa “Shënime shpjeguese” zëvendësohet me tekstin me të njëjtin emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 37

Aneksi 20 shfuqizohet.

Neni 38

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Aneksi 4. Firot dhe humbjet natyrale

Kodi NK	Përshkrimi	Ambalazhimi/paketimi/ruajtja	Norma
0901	Kafe jo e përpunuar, jo e dekafeinizuar, në kokrra dhe me lëvozhgë		1,2% në peshë
2203	Birrë e bërë nga malti jo e ambalazhuar		deri 2 0/00 në volum
2204	Verë prej rrushit të freskët, përfshirë verërat e pasuruara me alkool; musht rrushi përveç atij të kreut 2009:	1) Në fuqi druri	4% në volum
		2) Në enë të tjera	1% në volum



2205	Vermuth dhe verëra të tjera prej rrushit të freskët aromatizuar me bime apo me substanca aromatizuese:	1) Në fuçi druri	4% në volum
		2) Në enë të tjera	1% në volum
2206	Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hidromel); përzierjet e pijeve të fermentuara dhe përzierjet e pijeve të fermentuara dhe pijeve jo-alkoolike, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër:	1) Në fuçi druri	4% në volum
		2) Në enë të tjera	1% në volum
2207	Alkool etilik jo i denaturuar i një force alkoolike të barabartë ose më tepër se 80% ndaj volumit	1) Në fuçi druri	4% në volum anhider
		2) Në enë të tjera	1% në volum anhider
2207	Alkool etilik i denaturuar për t'u ambalazhuar 5:	1) Në enë me kapacitet më shumë se 50 litra	3% në volum anhider
		2) Në enë të tjera me kapacitet të barabarta ose më të vogla se 50 litra	5% në volum anhider
2208	Alkool etilik jo i denaturuar i një force alkoolike ndaj volumit prej me pak se 80 % vol; pije alkoolike, likere dhe alkoole të tjera	1) Në fuçi druri	4% në volum anhider
		2) Në enë të tjera	1% në volum anhider
2709	Vajra bruto të naftës dhe mineraleve bituminoze		1 0/00 në peshë
2707	Vajra dhe produkte të tjera të distilimit në temperaturë të lartë të katranit të qymyrit; produkte të ngjashme në të cilat pesha e përbërësve aromatikë e tejkalon atë të atyre joaromatikë:		1% në peshë
2710	Vajrat e naftës dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze, ndryshe nga vajrat bruto; përgatitje të paspecifikuara dhe të papërfshira diku tjetër, që përmbajnë ndaj peshës 70 % apo më shumë vajra naftë apo vajra të fituara nga mineralet bituminoze, këto vajra duhet të jenë përbërësit bazë të preparatit; mbetje vajrash:		
	Vajra të lehtë white spirit		deri në 20/00 në volum në
	Vajra të tjerë të lehtë përveç white spirit	1) në depozita deri 500 mc	deri në 20/00 në volum në 150C
		2) në depozita mbi 500 mc	deri në 20/00 në volum në 150C
	Vajra të mesëm dhe gazoile		deri 0,30/00 në volum në 150C
	Vajra të rëndë si lëndë djegëse		deri në 0,20/00 në volum në 150C
	Vajra lubrifikante		deri në 0,20/00 në peshe
2713	Vajra mineralë të denaturuar për përdorime të veçanta		
	deri 20/00 në volum në 150C ose në peshë sipas mënyrës të taksimit		
2715	Bitum naftë		1% në peshë
2715	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyral, në bitumin natyral, në bitumin e naftës, në katranin mineral apo në terpentinën e katranit mineral (p.sh., mastiçët bituminoze, “cut-backs”)		1% në peshë
2901	Hidrokarburet aciklike:		
	3 deri 4 atome karbon të lëngëzuara		deri 30/00 në peshë
	nga 5 deri në 12 atome karbon		deri 20/00 në volum në 150C
	mbi 12 atome karbon		deri 10/00 në peshë
	Hidrokarburet ciklike:		



2902	kodet 2902 11 deri 2902 70	deri 20/00 në peshë
	kodi 2902 90	deri 10/00 në peshë
2905 11 00	Metanol (alkool metilik)	deri 2% në volum anhidër
3403	Preparatet lubrifikuese që përmbajnë vajra minerale	20/00 në peshë
3811	Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, stabilizator rrëshirë, përmirësues viskoziteti, preparatet kundër korrozionit dhe elemente të tjera të përgatitura shtese, për vajrat minerale (përfshirë benzinën) apo për lëngje të tjera të përdorura për qëllime të njëjta, si edhe vajrat minerale:	20/00 në peshë
3817 00	Alkilbenzenët e përziera dhe alkilnaftalenet e përziera, përveçse produktet e kreut 2707 apo 2902:	20/00 në peshë

Shënime

1. Firot natyrore në tabelë jepen për një periudhë ruajtjeje njëvjeçare; për periudha më të shkurtra se një vit, firot llogariten proporcionalisht për periudhën në stokim duke konsideruar si një muaj të plotë edhe një pjesë të muajit kur ka kaluar data 15; përjashtim bëjnë produktet e klasifikuara në kapitujt 22, 27 dhe 29, për të cilat firot llogariten për çdo ditë të periudhës së mbajtjes apo ruajtjes. Për raste të veçanta, firot llogariten në datën e hyrjes në magazinë, që është mbartja në fillim të vitit fiskal ose nëse është më e vonë, data e inventarit të fundit duke i shtuar sasitë e shtuara në vijim; në këto raste matja e tyre, sipas kolonës (3) është shënuar me një yll.

2. Për produktet e kodit 2008, në rastet kur aplikohet akcizë, përveç firove në peshë pranohet firoja në volum anhidër parashikuar për alkoolin etilik që përmbahet në produkt.

3. Për birrën e pastazhonuar e paraqitur në kushte të ndryshme nga hedhja për konsum, firo e pranueshme përcaktohet për qëllime të llogaritjes së detyrimeve doganore ndryshe nga ato të akcizës.

4. Firo e lidhura me alkoolin dhe produkteve të tjera të kodeve 2207 dhe 2208 të NK jo të denaturuar, të ruajtura në fuçi druri, shtohen me 1% kur bëhet fjalë për fuçi druri me kapacitet jo më shumë se 4 hektolitra; e njëjta shtesë, e akumulueshme me të mëparshmen aplikohet në rastet e fuçive me dru qershie.

5. Për alkoolin etilik të denaturuar të kodit 2207 të NK, firoja përfshin edhe humbjet gjatë filtrimit, futjes në shishe dhe për çdo arsye tjetër teknike.

SHËNIME SHPJEGUESE

1. Të përgjithshme

1.1 Produktet, të cilat qarkullojnë në regjim pezullues janë të shoqëruara me një dokument i cili është në përputhje me dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat n 137 RSH.

1.2 Dokumenti duhet të plotësohet në mënyrë që të lexohet qartë dhe pa gabime.

Informacionet mund të paraprintohen. Nuk duhet të ketë as fshirje dhe as korrigjime.

1.3 Kjo letër është e bardhë për të gjitha kopjet me madhësi 210 mm x 297 mm me një tolerancë maksimale minus 5 mm ose 8 mm dhe më shumë në lidhje me gjatësinë e saj.

1.4 Çdo hapësirë e papërdorur në kutitë 18 a deri në 22 c duhet të shënohet një vijë, në mënyrë që asgjë nuk mund të shtohet aty. Dokumenti mund të ketë tri artikuj të ndryshëm të produkteve, të cilat duhet të jenë në të njëjtën kategori të produkteve të akcizës.

1.5 Dokumenti administrativ shoqëruar përbëhet nga katër kopje: Kopja nr. 1: ruhet nga dërguesi;

Kopja nr. 2: ruhet nga pritësi;

Kopja nr. 3: i kthehet dërguesit si rakordim për veprimin e kryer dhe në raste të mundshme edhe me vulën e autoriteteve kompetente të zyrës doganore pritëse;

Kopja n° 4: i dërgohet autoriteteve kompetente të zyrës doganore nga pritësi

Autoritetet kompetente të nisjes mund të kërkojnë që t'u dërgohet kopje suplementare.

1.6 Kopjet nr. 2, 3 dhe 4 duhet të shoqërojnë produktet gjatë transportit të tyre.

1.7 Kur ky dokument përdoret për një transport, i cili kryhet nëpërmjet kanalizimeve (tubacioneve), kompania nisëse duhet t'i dërgojë kopjet nr. 2, 3 dhe 4 pritësit me mjetet më të shpejta që është e mundur. Në çdo rast ky dokument duhet të mbërrijë në vendin e shkarkimit brenda 24 orëve që pason marrjen e produktit për të cilin raportohet.

2. Rubrikat

Kutia n°1. Dërguesi: emri dhe adresa e plotë

Kutia n. 2 Numri i akcizës së dërguesit: numri i regjistrimit i lëshuar dërguesit nga autoriteti kompetent.

Kutia n°3 Numri i referencës: çdo dërgesë duhet të përmbajë një numër reference, i cili lejon identifikimin në llogaritë e dërguesit

Kutia n°4. Numri i akcizës së pritësit: Numri i regjistrimit në rastin e një depozituesi të miratuar.

Kutia n°5. Numri i faturës: Në këtë kuti shënohet numri i faturës tatimore me TVSH-në ose nr. i dokumentit të shoqërimit kur mungon e para.



Kutia n°6. Data e faturës : Data e transmetimit të dokumentit shënuar në kutinë n° 5.

Kutia n° 6.1 Tipi i DSHA

Tip 1 Nën pezullim

Tip 2 Eksport

Tip 3 Lëvizje nga importi

Tip 4 Hedhje për konsum

Tip 5 Humbje

Tip 6 Firo/shkatërrim

Kutia n°7. Pritësi: emri dhe adresa e plotë dhe në rastin kur pritësi nuk është depozitues i miratuar, numrin e identifikimit të NIPT-it. Në rastin e produkteve të eksportuara, duhet shënuar emri i pritësit në vendin e eksportimit

Kutia n°7a. Vendi i lëvrimit: vendi efektiv i lëvrimit, nëse produktet nuk janë lëvruar në adresën e shënuar në kutinë n°7.

Në rast eksporti duhet shënuar “EKSPORT”, si dhe vendin e eksportimit. Për produktet e pranuar më pas nën regjim doganor (përveç hedhjes në qarkullim të lirë) duhet shënuar “NËN REGJIM DOGANOR”, si dhe vendin nga ku produktet i nënshtrohen kontrollit doganor.

Kutia n°8. Autoritetet kompetente të vendit të nisjes: emri dhe adresa e autoriteteve kompetente të ngarkuar me kontrollin e produkteve të akcizës nga vendi i nisjes.

Kutia n°9. Transportuesi: emri dhe adresa e personit përgjegjës për transportin (nëse është i ndryshëm nga ai i dërguesit).

Kutia n°10. Garancia: shënimi palën ose palët që përbëjnë garancinë.

Shënimi vetëm “dërguesi”, “transportuesi” ose “pritësi» sipas rastit.

Kutia n°11. Detaje të tjera rreth transportit: çdo informacion shtesë, për shembull emri i transportuesit, lloji i mjetit të transportit, targa e mjetit, lloji dhe identifikimi i vulave të vendosura.

Kutia n°12. Shteti nisës: Shteti nisës ku fillon transporti.

Duhet të përdoret një nga këto shkurtime: AL

Kutia n°13. Shteti i destinacionit: Shteti anëtar ku përfundon transporti.

Duhet të përdoren të njëjtat shkurtime. Për përdorim kur Shqipëria të jetë vend anëtar i BE-së.

Kutia n°14. Përfaqësuesi fiskal: nëse dërguesi ka një përfaqësues fiskal, shënimi në këtë kuti emrin e tij, adresën dhe numrin e identifikimit të TVSH-së dhe të akcizave (nëse ka).

Kutia n°15. Vendi i nisjes: Numri i autorizimit të magazinës.

Kutia n°16. Data e nisjes së dërgesës si dhe ora.

Kutia n°17. Kohëzgjatja e transportit: periudha e kohës së nevojshme normale për të kryer distancën

duke pasur parasysh mjetin transportues dhe distancën përkatëse.

Kutia n°18a. Përshkrimi i kolive të produkteve: Numri i identifikimit dhe numri i kolive, numri i ambalazheve në brendësi të kolive dhe përshkrimi tregtar i produkteve.

Përshkrimi mund të vazhdohet edhe në një fletë tjetër që do të jetë e bashkangjitur për çdo kopje. Një specifikim për ambalazhin mund të përdoret në këtë rast.

Alkooli etilik dhe pijet alkoolike, përfshi edhe birrën, duhet të paraqesin gradën alkolometrike që i korrespondon gradës së shënuar (përqindja në volum në 20° C).

Për birrën, të shënohet përqindja e alkoolit në volum 20° C, në përputhje me përshkrimet e kërkuara me ligj.

Për vajrat minerale, duhet shënuar detyrimisht dendësitë në 15° C.

Kutia n° 19a. Kodi i produktit NK.

Kutia n° 20a. Sasia: Sipas njësisë matëse t137 përshkruar në shtojcën numër 1 të ligjit konvertim në 20°C, (alkool dhe pije alkoolike); konvertim në 15°C (vajra minerale përveç mazutit të rëndë).

Kutia n°21a. Pesha bruto: pesha bruto e dërgesës.

Kutia n°22a. Pesha neto: shënimi peshën pa ambalazh të produkteve që i nënshtrohen akcizës në rastin e alkooleve dhe pijeve alkoolike, të vajrave minerale dhe të gjitha produkteve të duhanit me përjashtim të cigareve.

Kutitë nr 18 b deri në 22 b dhe 18 c deri 22 c: përdoren kur dërgesa përmban produkte të ndryshme nga ato të përshkruara në kutitë 18 a deri 22 a.

Kutia n°23. Detajet e garantimit dhe pagesës

Pagesa	kodi 1
Garanci	kodi 0
Përjashtim	kodi 3

Kutia n°24. Emri dhe vula e kompanisë, etj. : dokumenti duhet të plotësohet nga dërguesi ose në emër të tij. Emri dhe vula e kompanisë duhet të identifikohen. Dokumenti duhet të nënshkruhet, ose është e mundur që dërguesi të ketë autorizuar zëvendësimin e firmës me një vulë të veçantë. Në këtë rast duhet të figurojë shënimi “PËRJASHTIM I NËNSHKRIMIT”.

Kutia A Kontrollat: autoritetet kompetente regjistrojnë kontrollin e kryera në kopjet 2, 3 dhe 4. Nëse nuk ka vend më për të shkruar, vazhdohet në pjesën e prapme të dokumentit. Të gjitha shënimet duhet të nënshkruhen, të jenë me datë dhe të autentifikuar me vulën e funksionarit përgjegjës.

Kur produktet i nënshtrohen një regjimi doganor, kontrollin e kryera duhet të regjistrohen nga funksionari përgjegjës, vula speciale e përdorur kur është akorduar



një përjashtim i nënshkrimit vendoset gjithashtu në anën e djathtë sipër kutisë A.

Kutia B: Nëse gjatë lëvizjes, destinacioni i produkteve ndryshon siç shënohet në kutitë 7 ose 7a, dërguesi ose agjenti i tij duhet të shënojë destinacionin e ri në kutinë B.

Përveç kësaj, dërguesi duhet të lajmërojë menjëherë autoritetet kompetente të saj për ndryshimin e vendit të ri të lëvrimit.

Kutia C: Certifikata e pritjes: jepet nga pritësi i produkteve. Kur pritja e produkteve në një magazinë i nënshtrohet një kontrolli fiskal ose kur produktet janë

eksportuar ose janë në një regjim doganor ndryshe nga hedhja në qarkullim të lirë, autoriteti kompetent ose zyra doganore sipas rastit, do të lëshojë këtë certifikatë që kërkohet.

Rekomandohet të vërtetohet nga ana e pasme e kopjes nr. 2, e ruajtur kjo nga pritësi, për marrjen e produkteve.

Në rastin ku kopja nr. 3 humb gjatë dërgimit të saj për tek dërguesi, veprimi mund të rakordohet lehtë ku dërguesi i bën një kërkesë pritësit për të pasur një kopje të kopjes nr. 2 të certifikuar.

Aneksi 23

Modeli 1

NJOFTIM PËR PRODHIM BIOKARBURANTI

Shoqëria _____ njofton degën e doganës _____ se ka përfunduar prodhimin e bio-karburantit dhe kërkon kryerjen e procedurës së kontrollit doganor sipas pikës 2 të nenit 46.

Sasia e prodhuar _____

Depozituar në _____

Modeli 2

Procesverbal verifikimi

Dega e Doganës _____

Doganierët përgjegjës _____

Pas verifikimit të njoftimit Nr _____ DT _____ të depozituesi i miratuar _____

Konstatohet se sasia e produktit të magazinuar është

Depoja nr _____ Sasia _____ Hyrja plumboset me _____

Dalja plumboset me _____

Mostra të marra _____ Plumbosur me _____

Depoja nr _____ Sasia _____ Hyrja plumboset me _____

Dalja plumboset me _____

Mostra të mara _____ Plumbosur me _____

Depoja nr _____ Sasia _____ Hyrja plumboset me _____

Dalja plumboset me _____

Mostra të mara _____ Plumbosur me _____

Depoja nr _____ Sasia _____ Hyrja plumboset me _____

Dalja plumboset me _____

Kopje për Doganën

Kopje për depozituesin e miratuar



Modeli 3

Kartelë inventari Produkti _____

Certifikatë e analizave të laboratorit doganor _____

Datë _____

Depoja nr _____ Sasia _____ Hyrja plumboset me _____

Dalja plumboset me _____

Daljet:

Sasia	DSHA nr. dt.	Sasia e mbetur	Plumbosur me	Doganieri emër, mbiemër, firmë	Përfaqësuesi operatorit emër, mbiemër, firmë

Kopje për Doganën

Kopje për depozituesin e miratuar

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 259 lekë